



# STUDIM LIDHUR ME KOMUNITETET E ENERGJISË PËR QYTETARËT NË SHQIPËRI



Supported by:



Federal Ministry  
for the Environment, Nature Conservation  
and Nuclear Safety



European  
Climate Initiative  
EUKI

based on a decision of the German Bundestag

**Publikuar nga:** Milieukontakt Shqipëri

**Datë:** Qershor 2021

**Autori:** Dr. Andrian Vaso

**Kontakt:** office@milieukontakt.org

**Adresa:** Rr: Xhorxhi Martini, Pall.

Teuta Konstruksion Shk.3/8, Tirane

tel/Fax: +355 (4) 2256528

www.milieukontakt.org



**Falenderime për kontribuesit e mëposhtëm:**

Msc. Albana Joxhe

Dr. Antonia Proka

Msc. Arion Sauku

Msc. Valbona Mazreku

**Përpunimi grafik dhe faqosja:**

Ergys Bejleri / Oxigen

---

Studimi është përgatitur në kuadër të projektit Akademia Europiane e Energjisë,  
"EUCENA" mbështetur nga programi "EUKI" Iniciativa Europiane për Klimën

Opinionet e këtij publikimi janë përgjegjësi e autorit dhe jo domosdorisht reflektojnë  
pikëpamjen e Ministrisë Federale të Mjedisit, Mbrojtjes së Natyrës dhe Sigurisë Nukleare.

**Supported by:**




Federal Ministry  
for the Environment, Nature Conservation  
and Nuclear Safety



European  
Climate Initiative  
EUKI

**based on a decision of the German Bundestag**



**STUDIM LIDHUR ME  
KOMUNITETET E ENERGJISË  
PËR QYTETARËT NË SHQIPËRI**

---

# PËRMBAJTJA

	Akronimet	6
1.	HISTORIKU	8
1.1.	Përkufizim	8
1.2.	Elementët dhe Kushtet Kryesore	8
1.3.	Parimet e Bashkëpunimit	8
1.4.	Llojet e Aktiviteteve	9
1.5.	Konceptet e Reja	10
2.	ANALIZA RREGULLATORE DHE HARTËZIMI POTENCIAL PËR SHQIPËRINË	12
2.1.	Përmbledhje e dokumenteve përkatëse	12
2.1.1.	Korniza Ligjore	12
2.1.2.	Komuniteti i energjisë në kornizën ligjore dhe të politikave	15
2.1.2.1.	Aspektet e ndryshimeve klimatike në Shqipëri	15
2.1.2.2.	Integrimi gjinor	15
2.2.	Zhvillimet e fundit në Shqipëri	16
2.2.1	Mekanizmat ligjorë, institucionalë dhe mbështetës	16
2.2.2	Iniciativat në Shqipëri për sektorin e ER-së	17
2.3	Hartëzimi i palëve të interesit për zhvillimin e energjisë për qytetarët në Shqipëri	19
2.3.1	Qasja	19
2.3.1.1	Politike	20
2.3.1.2	Ekonomike	21
2.3.1.3	Sociale	21
2.3.1.4	Teknologjike	22
2.3.1.5	Ligjore	22
2.3.1.6	Mjedisore	23
2.3.2	Identifikimi i Palëve të Interesit	23
2.4	Rishikimi i PESTLE-it në mjedisin shqiptar	24
2.4.1.1	Politikat për energjinë	26
2.4.1.2	Implikimet sociale	26
2.4.1.3	Drejtësia në energji	27
2.4.2	Ndikimi në sistemin e energjisë	28
2.4.2.1	Ndikimi në rrjetet e shpërndarjes	28

---

2.4.2.2	Ndikimi në kostot e sistemit	29
2.4.3	Përfundime	30
2.4.4	Problemet që duhen trajtuar	31
2.4.5	Pengesat ndaj komunitetit të energjisë	32
2.4.6	Rekomandime	34
2.5	Skemat Rregullatore dhe Financiare si dhe Korniza për CEC	36
2.5.1	Struktura ligjore për komunitetet e energjisë	36
2.5.2	Skemat financiare dhe korniza rregullatore	37
2.5.3	Skema kornizë për CEC	38
3	MODEL (E) POTENCIALE BIZNESI PËR CEC	40
3.1	Modelet, teknologjitë, pilotimet ekzistuese evropiane	40
3.2	Ide të reja dhe identifikimi i modeleve më të fundit të biznesit të CEC-ve në Shqipëri	41
3.2.1	Bashkia Tiranë – Fondi i Komunitetit	41
3.2.2	Korniza Ligjore Shqiptare për Ndërmarrjet Sociale	44
3.3	Modeli i Vlerësimit të CEC-së dhe Rekomandimet në Shqipëri	45
3.3.1	Modeli tipik	46
3.3.2	CEC Potencile në Shqipëri	47
3.4	Perspektiva dhe përfundimet për kooperativat e energjisë	48
3.4.1	Vështrim i përgjithshëm mbi kooperativat e energjisë	48
3.4.2	Ndikimi socio-ekonomik i kooperativave të energjisë	49
3.4.3	Mjeti për fuqizimin e grave dhe drejtësinë gjinore	51
3.4.4	Pronësia e energjisë vendore/ modelet e kooperativave në BE	52
3.4.4.1	Përvoja e Danimarkës	52
3.4.4.2	Përvoja e Gjermanisë	52
3.4.4.3	Përvoja e Irlandës	52
3.4.4.4	Përvoja e Greqisë	53
3.4.5	Përmbledhje e përvojave si mësim të nxjerra	53
3.4.6	Hapat përmbledhës për CEC shqiptare	65
4.	REFERNACAT	56

---

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Llojet e aktiviteteve të CEC-ve	9
Figura 2: Analiza e PESTLE-it për zbatimin e energjisë së rinovueshme	20
Figura 3: Trajektorja e synuar e BRE-ve	22
Figura 4: Skema fillestare për CEC-në	37
Figura 5: Cikli i zbatimit të programit "Fondi i Komunitetit"	43
Figura 6: Elementë të grupeve të energjisë	45
Figura 7: Koncepti i rrjetit të komunitetit	46
Figura 8: Struktura organizative e kooperativës	48
Figura 9: Modeli i biznesit i energjisë së kooperativës	50
Figura 10: Zbatimi i strategjive gjinore rrit barazinë për gratë e burrat	51

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Palët e interesit të Sektorit të Energjisë në Shqipëri	25
Tabela 2: Komunitetet e energjisë me dhe pa rrjete publike	29
Tabela 3: Pengesat ndaj komunitetit të energjisë	33
Tabela 4: Strukturat e mundshme ligjore për komunitetet e energjisë	36
Tabela 5: Kuadri ligjor për ndërmarrjet sociale në Shqipëri	44

## AKRONIMET

AEE	Agjencia e Efiçencës së Energjisë
EB	Energjia Blu
CEC	Komuniteti i Energjisë për Qytetarët
KN	Kontratat për Ndryshim
KM	Këshilli i Ministrave
OSHC	Organizata e Shoqërisë Civile
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
EC	Komuniteti i Energjisë
EE	Efiçensa e Energjisë
DEE	Direktivë për Efiçensën e Energjisë
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
ERE	Enti Rregullator i Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
FIT	Feed-in-Tariff
GS	Gazet Serrë
DTBEE	Direktiva e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike
INF	Institucioni Ndërkombëtar i Financimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti për Ndhmën e Para-Anëtarësimin
PNNK	Paneli Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MFE	Ministria e Financës dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
NEEAP	Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
SKE	Strategjia Kombëtare e Energjisë
AKPT	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
NZEB	Ndërtesat me Pothuajse Zero Energji
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
PV	Panele Fotovoltaike
ER	Energji e Rinovueshme
DER	Direktiva e Energjisë së Rinovueshme
OER	Operatori i Energjisë së Rinovueshme
BRE	Burimet e Rinovueshme të Energjisë
SME	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
AZHT	Agjencia e Zhvillimit të Territorit
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore

# 1. HISTORIKU

Në vitin 2018, Paketa e Energjisë së Pastër të Komisionit Evropian njohe të drejtën e komuniteteve lokale dhe qytetarëve për të luajtur një rol aktiv në sektorin e energjisë duke i përcaktuar si “Komunitete të Energjisë”.

“Komunitetet e energjisë” janë specifikuar në dy ligje të veçanta të Paketës së Energjisë së Pastër. Direktiva e rishikuar e Energjisë së Rinovueshme (BE) 2018/2001 përcakton kornizën për “Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme” që mbulon energjinë e rinovueshme. Direktiva e rishikuar e Tregut të Brendshëm të Energjisë Elektrike (BE) 2019/944 përcakton rolet dhe përgjegjësitë e reja për “Komunitetet e Energjisë për Qytetarët” në sistemin e energjisë që mbulon të gjitha llojet e energjisë elektrike.

## 1.1. PËRKUFIZIM

Sipas Direktivës (BE) 2019/944, Neni 2 (11)<sup>1</sup>, ‘komuniteti i energjisë për qytetarët’ është një subjekt juridik që:

- (a) bazohet në pjesëmarrje vullnetare dhe të hapur dhe kontrollohet në mënyrë efektive nga anëtarët ose palët e interesit që janë persona fizikë, autoritete lokale, përfshirë bashkitë ose ndërmarrjet e vogla.
- (b) ka për qëllim kryesor të sigurojë përfitime të përbashkëta mjedisore, ekonomike ose sociale për anëtarët e saj ose palët e interesit ose për zonat lokale ku ai operon, sesa të gjenerojë fitime financiare; dhe
- (c) mund të angazhohet në prodhim, duke përfshirë nga burimet e rinovueshme, shpërndarjen, furnizimin, konsumin, grumbullimin, ruajtjen e energjisë, shërbimet e efikasitetit të energjisë ose shërbimet e tarifimit për automjetet elektrike ose të sigurojë shërbime të tjera të energjisë për anëtarët ose palët e saj të interesit.

## 1.2. ELEMENTËT DHE KUSHTET KRYESORE

Komunitetet e Energjisë karakterizohen nga disa elemente dhe kushte kryesore të përshkuara në direktivat përkatëse të BE-së dhe të përcaktuara në legjislacionin kombëtar të disa vendeve. Këto elemente dhe kushte renditen më poshtë:

⇒ **Qeverisja:** Pjesëmarrja është ‘e hapur dhe vullnetare’. Më konkretisht, pjesëmarrja në projektet e energjisë është e hapur për të gjithë anëtarët e mundshëm lokal bazuar në kritere jo-diskriminuese.

⇒ **Pronësia dhe kontrolli:** Pjesëmarrja dhe kontrolli efektive nga qytetarët, autoritetet lokale dhe bizneset më të vogla, aktiviteti kryesor ekonomik i të cilave nuk është sektori i energjisë.

⇒ **Qëllimi:** Qëllimi kryesor është të gjenerojë përfitime sociale dhe mjedisore dhe jo të përqendrohet në fitime financiare.

⇒ **Fushëveprimi gjeografik:** Afrueshmëria midis projektit të energjisë së rinovueshme dhe Komunitetit të Energjisë është e një rëndësie të madhe.

⇒ **Aktivitetet:** Komunitetet e Energjisë mund të mbulojnë një gamë të gjerë aktivitetesh duke iu referuar të gjitha formave të energjisë së rinovueshme në sektorët e energjisë elektrike dhe ngrohjes.

⇒ **Pjesëmarrësit:** Personat fizikë, autoritetet lokale dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, pjesëmarrja e të cilëve nuk përbën aktivitetin e tyre kryesor ekonomik. Komunitetet e Energjisë gjithashtu duhet të sigurojnë që pjesëmarrja është e arritshme për konsumatorët nga familjet me të ardhura të ulëta ose në nevojë.

⇒ **Autonomia:** Një Komunitet i Energjisë ‘duhet të jetë i aftë të mbetet autonom nga anëtarët individualë dhe aktorët e tjerë tradicionalë të tregut që marrin pjesë në komunitet si anëtarë ose si palë interesi.

## 1.3. PARIMET BASHKËPUNUESE

Komunitetet e Energjisë duhet gjithashtu të respektojnë shtatë (7) Parimet e Bashkëpunimit të përcaktuara nga Aleanca Bashkëpunuese Ndërkombëtare (ABN). Parimet janë:

1. Anëtarësimi vullnetar dhe i hapur
2. Kontrolli demokratik i anëtarëve
3. Pjesëmarrja ekonomike përmes pronësisë direkte
4. Autonomia dhe pavarësia
5. Edukimi, trajnimi dhe informimi
6. Bashkëpunimi
7. Shqetësimi për komunitetin

<sup>1</sup> <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L0944>



## 1.4. LLOJET E AKTIVITETEVE

Përkufizimi i Komuniteteve të Energjisë për Qytetarët (CEC) identifikon llojet e ndryshme të aktiviteteve ku mund të përfshihen CEC-et (shihni Figurën 1, më poshtë). Kjo nuk ka për qëllim të konsiderohet si strukturë, për shembull si një subjekt që kryen një grup të integruar aktiviteteve. Përkundrazi, është e pranueshme që struktura organizative e CEC-ve të mund të përdoret nga qytetarët, bizneset e vogla dhe autoritetet lokale për të marrë pjesë në aktivitete në të gjithë sektorin e energjisë.



**Figura 1:**  
Llojet e aktiviteteve të CEC-ve

**Burimi:**  
*Integrimi i fuqisë së komunitetit në ishujt e energjisë*

Meqenëse aktivitetet e integruara mund të parashikohen, nuk është kjo arsyeja kryesore për renditjen e aktiviteteve në përkufizim. Gjithashtu, nuk përjashtohen aktivitetet që nuk përmenden specifikisht.

Zakonisht, iniciativat në shkallë më të vogël të drejtuara nga qytetarët lidhen kryesisht me aktivitetet e gjenerimit të rinovueshëm. Kërkimi mbi përvojën ndërkombëtare tregon se komunitetet e energjisë mund të përfshihen në disa ose në të gjitha aktivitetet e mëposhtme:

•**Gjenerimi:** projektet e komunitetit të energjisë përdorin ose zotërojnë në mënyrë kolektive asetet gjeneruese (kryesisht diellore, me erë, hidro) ku anëtarët nuk e konsumojnë vetë energjinë e prodhuar, por e kalojnë atë në rrjet dhe ia shesin një furnizuesi (CEER, 2019).

•**Furnizimi:** shitja (dhe rishitja) e energjisë elektrike dhe e gazit të klientët (energji elektrike, peletë druri, biogaz dhe të tjera). Komunitetet e mëdha mund të kenë një numër të madh klientësh me pakicë në afërsi të tyre dhe gjithashtu mund të angazhohen në aktivitete grumbullimi duke kombinuar

ngarkesat e klientëve dhe fleksibilitetin ose të gjenerojnë energji elektrike për shitje, blerje ose për ankand në tregjet e energjisë elektrike (Parlamenti Evropian & Këshilli i Bashkimit Evropian, 2019).

•**Konsumi dhe ndarja:** energjia e prodhuar nga komuniteti i energjisë përdoret dhe ndahet brenda komunitetit. Kjo përfshin si konsumin (vetë-konsumin individual dhe kolektiv) dhe ndarjen lokale të energjisë midis anëtarëve, që prodhohet nga stacionet gjeneruese brenda një komuniteti.

•**Shpërndarja:** pronësia dhe/ ose menaxhimi i rrjeteve të shpërndarjes të drejtuara nga komuniteti, të tilla si rrjetet lokale të energjisë elektrike ose ngrohjes së zonave në shkallë të vogël dhe rrjetet e (bio) gazit; shpesh kooperativat mund të bëjnë prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë, por infrastruktura e rrjetit është thelbësore për biznesin e tyre (Yildiz et al., 2015).

•**Shërbimet e energjisë:** efikasiteti i energjisë ose kursimi i energjisë (p.sh., rinovimi i ndërtesave, auditimi i energjisë, monitorimi i konsumit, ngrohja dhe vlerësimet e cilësisë së ajrit); fleksibiliteti, ruajtja e energjisë dhe integrimi i rrjetit inteligjent; monitorimi i energjisë dhe menaxhimi i energjisë për operacionet e rrjetit; shërbimet financiare.

•**Elektro-lëvizshmëria:** bashkëpërdorimi i mjetit, bashkë-udhëtimi dhe/ose funksionimi dhe menaxhimi i stacioneve të karikimit, ose sigurimi i kartave elektronike për anëtarët dhe kooperativat.

•**Aktivitete të tjera:** shërbime konsulence për të zhvilluar iniciativa në pronësi të komunitetit ose për të krijuar kooperativa lokale, fushata informimi dhe ndërgjegjësimi ose masa ndaj varfërisë për lëndë djegëse.

## **GRUPE QYTETARËSH PËR ENERJINË**

Ideja që përmes nxitjes së ndërgjegjësimin të qytetarëve dhe komuniteteve në shkallë më të gjerë për çështjet e energjisë, bën që ata të kontribuojnë më shumë në skemat e energjisë. Kjo përfshin konsumatorin prodhues dhe komunitetin e energjisë, por shtrihet edhe më tej dhe përfshin qytetarët që fillojnë të marrin pjesë në zotërimin ose funksionimin e rrjeteve të shpërndarjes (p.sh. përmes bashkëpunimit dhe/ ose pronësisë/ menaxhimit në nivel bashkiak), dhe në furnizim (jo vetëm në prodhimin dhe hedhjen e energjisë elektrike në rrjet, por gjithashtu duke furnizuar klientët fundorë - ose përmes pjesëmarrjes në tregjet me shumicë të energjisë ose përmes furnizimit direkt) dhe kompanive të shërbimit të energjisë. Ky koncept pranon që si parakusht për t'u angazhuar në këto role, qytetarëve në radhë të parë duhet t'u sigurohet aftësia për t'u bërë pjesëmarrës të informuar për të ushtruar të drejtat e tyre për të marrë pjesë në mënyrë efektive në dimensionin politik të politikës së energjisë.

## **1.5. KONCEPTE TË REJA**

### **KONSUMATOR PRODHUES**

Ideja që qytetarët nuk janë vetëm konsumatorë, por që kanë edhe potencial për të qenë prodhues të energjisë, veçanërisht të energjisë së rinovueshme. Konsumatori Prodhues mund të luajë një rol aktiv në gjenerimin e energjisë, ruajtjen e energjisë dhe menaxhimin e kërkesës (p.sh., përmes njehsorëve dhe pajisjeve inteligjente për të monitoruar, kontrolluar dhe operuar përdorimin e energjisë).



## 2. ANALIZA RREGULLATORE DHE HARTËZIMI POTENCIAL PËR SHQIPËRINË

Gjatë viteve të fundit, janë bërë disa përpjekje kombëtare në vend për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet e standardeve dhe legjislacionit të BE-së në lidhje me efikasitetin e energjisë (EE) dhe zbatimin e energjisë së rinovueshme (ER).

### 2.1. PËRMBLEDHJE E DOKUMENTEVE PËRKATËSE

#### 2.1.1. KORNIZA LIGJORE

Shqipëria ka miratuar kornizën e mëposhtme legjislative për EE-në dhe ER-në:

##### Përshkrim

**Strategjia Kombëtare për Energjinë** ka përcaktuar synimet energjetike të vendit për të mundësuar integrimin evropian të Shqipërisë në të gjithë infrastrukturën energjetike evropiane. Objektivat e REV-ve janë:

- Synimi i energjive të rinovueshme kundrejt konsumit total do të arrijë 42% në vitin 2030.
- Reduktimi i emetimeve të GS-ve kundrejt totalit do të arrijë 11.5% në vitin 2030.

**Plani Kombëtar i Veprimit për Efikasitetin e Energjisë** që përcakton synimet e EE-së për të gjithë sektorët ekonomikë dhe socialë. Mbështetja ndërkombëtare mund të vazhdojë, por për të rritur veprimet e EE-së kërkohet disponueshmëria e fondeve të rritura kombëtare (publike dhe private). Për të realizuar pjesën më të madhe të masave të EE-së, ligji i EE-së kërkon zhvillimin e një Fondi për Efikasitetin e Energjisë, si mekanizëm i mbështetjes financiare për zbatimin e projekteve të EE-së në sektorin publik dhe privat. Duhet parë si mjet për shfrytëzimin e burimeve më të mëdha nga palët e jashtme (INF-së dhe donatorët, si dhe bankat private).

**Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme** që përcakton synimet e BRE-ve për të gjithë sektorët e energjisë elektrike, transportit dhe ngrohjes. Ky Plan bazohet në detyrimet e Shqipërisë si Palë Kontraktuese në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për të qenë në përputhje me Direktivat e BE-së për promovimin e burimeve të rinovueshme të energjisë. Shqipëria është e detyruar të rrisë pjesën e burimeve të rinovueshme në 38% të konsumit total të energjisë deri në vitin 2020, e cila duhet të rritet më tej deri në 42.5% deri në vitin 2030.

**Ligji për Burimet e Rinovueshme të Energjisë nr. 7/2017** transpozon pjesërisht Direktivën 2009/28 / të BE-së. Objektivi i Ligjit për BRE-të është lehtësimi i shfrytëzimit të burimeve të konsiderueshme të ER-së të Shqipërisë, në HEC-et e vogla, Sistemet me Ujë të Nxehtë Diellor, Centrale Elektrike PV, sistemet efikase të ngrohjes tradicionale dhe industriale të biomasës, si dhe burime të tjera të ER-së.

**Ligji për Performancën e Energjisë së Ndërtesave Nr. 116/2016.** Ky Ligj përfshin kërkesat për ndërtesat e reja në shfrytëzim dhe në pronësi të autoriteteve publike për të përmbushur përcaktimin e Ndërtesave me Energji Pothuajse Zero (NEPZ).

Politikat  
Kombëtare

Ligjet

## Ligjet

**Ligji për Eficiencën e Energjisë Nr. 124/2015** për të transpozuar dispozitat e Direktivës së BE-së 2012/27 / BE në kornizën legjislative shqiptare.

**Ligji për Etiketimin e produkteve që lidhen me energjinë Nr. 68/2012**, i cili transponon plotësisht Direktivën e BE-së 2010/30 / BE. Ky ligj përcakton detyrimin për informimin e konsumatorëve për konsumin e energjisë së produkteve të lidhura me energjinë.

**Ligji Nr. 9876/2008** për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e bio-lëndëve djegëse dhe lëndëve të tjera të rinovueshme të përdorura në transport promovon prodhimin dhe përdorimin e bio-lëndëve djegëse të rinovueshme për të zëvendësuar nënproduktet e naftës në sektorin e transportit.

**Ligji Nr. 9501/2006** për ratifikimin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, i cili siguron një kornizë ligjore për konvergencën me acquis-in e energjisë të Bashkimit Evropian<sup>2</sup>.

**Ligji Nr. 8987/2002** për krijimin e ambienteve për ndërtimin e kapaciteteve të reja të gjenerimit të energjisë

## VKM

**VKM Nr.1094 / 2020** për miratimin e metodologjisë kombëtare për llogaritjen e performancës së energjisë të ndërtesave.

**VKM Nr.934/2020** për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për mënyrën e përzgjedhjes së certifikatave të performancës së energjisë të ndërtesave që do të jenë objekt vlerësimi si dhe procesi i monitorimit të tyre.

**VKM Nr.537/2020** për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave.

**VKM Nr.256/2020** për metodologjinë e llogaritjes së niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë të ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave.

**VKM Nr.580/2019** për miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

**VKM Nr.407/2019** për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve dhe eksperiencës profesionale për energjinë.

**VKM Nr.342/2019** për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për audituesit e energjisë.

**VKM Nr.687 / 2017** për miratimin e metodologjisë për caktimin e çmimit

**VKM Nr.1094 / 2020** për miratimin e metodologjisë kombëtare për llogaritjen e performancës së energjisë të ndërtesave.

**VKM Nr.934 / 2020** për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për mënyrën e përzgjedhjes së certifikatave të performancës së energjisë të ndërtesave që do të jenë objekt vlerësimi si dhe procesi i monitorimit të tyre.

**VKM Nr.537 / 2020** për kërkesat minimale të performancës energjetike të ndërtesave dhe elementeve të ndërtesave.

<sup>2</sup>“Acquis Communautaire për Energjinë” i BE-së përcaktohet në Aneksin I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe përfshin disa Direktiva dhe Rregullore të BE-së që janë thelbësore për rregullimin e sektorëve të energjisë të vendeve anëtare të BE-së.

## VKM

**VKM Nr.256/2020** për metodologjinë e llogaritjes së niveleve të kostos optimale për kërkesat minimale të performancës së energjisë të ndërtesave, njësive dhe elementeve të ndërtesave.

**VKM Nr.580/2019** për miratimin e Planit të Konsoliduar Kombëtar të veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë.

**VKM Nr.407/2019** për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve dhe eksperiencës profesionale për energjinë.

**VKM Nr.342/2019** për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për audituesit e energjisë.

**VKM Nr.687/2017** për miratimin e metodologjisë për caktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet Prodhuesve Ekzistues me Përparësi.

**VKM Nr. 369/2017** për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.

**VKM Nr. 27/2018** për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorë e vegjël me BRE duke përdorur pjesën e biodegradueshme të mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale.

**VKM Nr. 349/2018** për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve të tyre, të ndryshuar.

**VKM Nr. 430/2018** për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin elektronik të lejeve (e-leje)

**VKM Nr. 852/2016** për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë për Eficiencën e Energjisë.

**VKM Nr. 519/2016** për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike.

**VKM Nr. 822/2015** për miratimin e rregullave dhe procedurave për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike që nuk janë objekt i koncesioneve, të ndryshuar.

**VKM Nr. 839/2007** për përcaktimin e kushteve dhe të procedurave për rimbursimin e akcizës së paguar dhe krijimin e kushteve lehtësuese për ndërtimin e burimeve të prodhimit të energjisë elektrike, me fuqi të instaluar jo më pak se 5 MW, të ndryshuar.

## VKM të tjera

**Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 229/2019** për miratimin e Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e Garancive të Originës për energjinë elektrike të prodhuar nga BRE-ja.

**Udhëzimi i MIE-së Nr. 3/2019** për Miratimin e Procedurës së Autorizuar për Lidhjen me Sistemin e Shpërndarjes të Projekteve të Vogla të Rinovueshme për Vetë-Prodhuesit e Energjisë Elektrike nga Dielli.

**Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-së Nr. 214/2017** për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjen për Pjesëmarrjen në Bursën Shqiptare të Energjisë.

## 2.1.2. KORNIZA POLITIKE

Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Parisit në 22 Prill 2016, duke hyrë në epokën e re të procesit të politikës ndërkombëtare për çështjen e klimës. Në fakt, Shqipëria iu përmbajt Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) në vitin 1995 dhe Protokollit të Kiotos në vitin 2005. Shqipëria ka filluar procesin e ndryshimit të statusit të saj nga një vend në zhvillim në një vend të zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC-së. Ky proces është pjesë përbërëse e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian dhe përfshin ndërtimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të gazeve serrë (GS), formulimin dhe zbatimin e politikave për të reduktuar GS-të dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, transpozimin dhe zbatimin e Acquis-it të BE për ndryshimet klimatike.

### 2.1.2.1. ASPEKTET E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË SHQIPËRI

Emetimet e përgjithshme të gazeve serë në Shqipëri janë relativisht të ulëta (8.4 milion tonë në vitin 2009, nga të cilat afërsisht 60% e emetimeve të CO<sub>2</sub>) dhe më këtë Shqipëria synon të marrë pjesën që i takon me të drejtë për përpjekjet që po bëjnë për të shmangur ndryshimet e rrezikshme klimatike. Vendi ka profil unik të emetimit pasi prodhimi i energjisë elektrike bazohet aktualisht në prodhimin e burimeve të rinovueshme, me energjinë hidrike që siguron pjesën më të madhe të saj. FatCECësisht, ky kapacitet hidro-energetik është i prekshëm nga ndikimet e ndryshimeve klimatike. Përzierja unike e energjisë elektrike në Shqipëri është pozitive për faktin se sistemi elektrik është në nivel të dekarbonizimit, gjë të cilën vendet e tjera synojnë ta arrijnë vetëm në planin afatgjatë, por gjithashtu do të thotë se ka mundësi të kufizuara për politika dhe masa të mëtejshme në këtë sektor për të reduktuar emetimet. Ruajtja e përmbajtjes së ulët të emetimit të gazeve serë në prodhimin e energjisë elektrike dhe shkëputja e rritjes ekonomike nga rritja e emetimeve të gazeve serë në sektorë të tjerë janë faktorët kryesorë të vendit në lidhje me kontributin e zbutjes siç është Kontributi Kombëtar i Përcaktuar. Duke qenë se Shqipëria nuk ka të dhëna të sigurta në lidhje me gazet serë jo-CO<sub>2</sub>, kjo bën që Shqipëria të sigurojë Kontributin e saj Kombëtar të Përcaktuar në lidhje me CO<sub>2</sub>. Nëse përmirësohet cilësia e të dhënave të gazeve serrë jo-CO<sub>2</sub>, Shqipëria synon të zgjerojë Kontributin e saj Kombëtar të Përcaktuar edhe në gazet e tjerë serë.

## 2.1.2.2. INTEGRIMI GJINOR

Rëndësia e barazisë gjinore në procesin e zgjerimit të Bashkimit Evropian është theksuar në dokumente të ndryshme të BE-së, ndërkohë që Raportet e Komisionit Evropian kanë vënë në dukje vazhdimisht disa sfida me të cilat përballen vendet e Ballkanit perëndimor në arritjen e barazisë gjinore. Tabloja e (pa) barazisë gjinore e portretizuar nga KE-ja i afrohet gjithnjë e më shumë ilustrimit të çështjeve më të rëndësishme të barazisë gjinore siç përcaktohet nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) në Shqipëri: dhuna me bazë gjinore, pjesëmarrja politike dhe vendimmarrja, mungesa e integritimit gjinor, stereotipet gjinore dhe diskriminimi në tregun e punës.

Rezultatet e arsimimit në bazën e gjinisë kontribuojnë ndjeshëm në pabarazitë gjinore në tregun e punës dhe hendekun gjinor të pagave. Modelet kryesore gjinore janë të dukshme në arsimin e lartë, i cili karakterizohet nga një ndarje e konsiderueshme horizontale. Në arsimin profesional, shumica e të diplomuarve (afërsisht 82%) janë djem. Arsyet themelore janë mentaliteti i përbashkët në lidhje me të ashtuquajturat “profesione për meshkuj”, klima sociale në shkollat profesionale, lloji i programeve mësimore të ofruara dhe perspektivat e punësimit të vajzave pas diplomimit.

Të dhënat/ informacionet mbi aspektet e lidhura me gjininë të administrimit të burimeve natyrore, ndotjes së mjedisit dhe ndikimet e ndryshimit të klimës mbeten shumë të kufizuara në Shqipëri, çka nxjerr në pah një përjashtim/ mangësi të qartë në ndërgjegjësimin, fjalimet dhe në politikë. Nuk ekziston asnjë informacion se deri në ç’masë janë integruar qëllimet e barazisë gjinore në kornizën ligjore dhe të politikave kombëtare për mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

## 2.2. ZHVILLIMET E FUNDIT NË SHQIPËRI

### 2.2.1 MEKANIZMAT LIGJORË, INSTITUCIONALË DHE MBËSHTETËS

#### Mekanizmat Ligjorë

##### Ligji BRE-ve nr. 7/2017:

- ⇒ Një bazë e re ligjore për mbështetjen e tarifës së rregulluar FIT "Feed-in-Tariff" për çmimin fiks për 15 vjet të HEC-eve me kapacitet nën 2MW.
- ⇒ Reduktimi i GS-ve, mbrojtja e mjedisit në përputhje me Kontributin Kombëtar të Përcaktuar të miratuar në UNFCCC.
- ⇒ Promovimi i ndërhyrjes së BRE-E në tregun APEX - themelimi i OER-së
- ⇒ Futja e BRE-E në rrjetin OST / OSSH - Integrimi rajonal.
- ⇒ Futja e HEC-ve të Vogla dhe të Mesme të kontraktuar deri më tani dhe menaxhimi i tarifës FIT.
- ⇒ Politika e tarifës FIT ndaj skemës së mbështetjes së KN-së dhe procedurave të lehta të ankandit.
- ⇒ Rritja e diversifikimit të BRE-ve - promovimi i PV-së mesatare dhe të madhe (120 deri në 500 MWp).
- ⇒ Vendosja e PV-së që nga viti 2017 (nga 1MWp / 2015 në 300 MWp në 2020).

*Drejtimet e politikave së BRE-ve dhe azhurnimi i nevojshëm i kornizës rregullatore*

##### • PKVER-ja është finalizuar në fillim të vitit 2018 nga MIE-ja me VKM 27/2018

- ⇒ PKVER-ja 2015-2020 është rishikuar në fillim të vitit 2018 për të përmbushur Synimin 38%.
- ⇒ Strategjia për vitet 2018-2030 përcakton objektivin e ri 45%.
- ⇒ Strategjia për vitet 2018-2030 ndjek objektivin e INDC-së për GS-të -11.5%.

##### • Politikë e re për vendosjen e BRE-ve për të nxitur investimet në energji

- ⇒ Rishikimi i procedurave të aplikimit në ankande më të drejtpërdrejta dhe në ankande hibride.
- ⇒ Shqyrtimi i zhvillimit të HEC-eve për të zvogëluar rrezikun në përmbushjen e objektivit të vitit 2020.
- ⇒ Vlerësimi i Gatishmërisë së Rinovueshme që do të zhvillohet nga ANER-i në fund të vitit 2019.

- ⇒ Rishikimi i PKVER-së për vitet 2018-2020 përmes investimit dhe llojit të diversifikimit të BRE-ve.
- ⇒ Vendosja shumë shpejt e vetë-konsumit PV.

#### Institucionet

##### Agjencia përgjegjëse për BRE-të

- Detyrat dhe Përgjegjësitë e MIE-së

- ⇒ Krijimi, regjistrimi dhe azhurnimi i regjistrit të prodhuesve të energjisë elektrike.
- ⇒ Regjistrimi i bilancit të energjisë elektrike për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike të BRE-ve.
- ⇒ Hartimi, dorëzimi dhe Monitorimi i PKVER-së.
- ⇒ Llogaritja dhe dorëzimi në Ministri dhe ERE deri në datën 1 Qershor të çdo viti për vlerësimin e pjesës share së BRE-ve.

- Operatori i Energjisë së Rinovueshme – OER

- ⇒ Përgjegjës për faturimin dhe arkëtimin nga Furnizuesi i BRE-ve, i pagesave për të gjitha kategoritë e prodhuesve me përparësi.
- ⇒ Përgjegjës për nënshkrimin dhe menaxhimin e KN-së.
- ⇒ OER duhet të sigurojë mbajtjen e regjistrave të detajuar në lidhje me të gjitha masat që përfshijnë dhënien e ndihmës.
- ⇒ OER publikon çdo vit detaje të llogaritjeve dhe pagesave sipas KN-së.

#### Mekanizmi mbështetës

- KM-ja është i autorizuar të miratojë masa për të promovuar përdorimin e BRE-ve me propozim të MIE-së.
- Nxitja e tarifës FIT për Stacione deri në kapacitetin e instaluar prej 2 MW PV dhe 3MW.
- Kontratë e gjatë për Prodhuesit e Energjisë së Rinovueshme duke lëshuar një Marrëveshje për Blerjen e Energjisë (MBE) të autorizuar deri në vitin 2020.
- Nxitja e tarifës FIT për Stacione deri dhe duke përfshirë një kapacitet të instaluar më shumë se 2 MW do të marrë mbështetje sipas Kontratave për Ndryshim (KN) - sipas skemës së ankandit.

#### Kontratat për Diferencën (KD)

- Mbështetja bazohet në një premium të ndryshueshëm për çmimin e paracaktuar (çmimi strike) dhe çmimin e tregut për energjinë elektrike - çmimi referues.



- Çmimi i paracaktuar duhet të llogaritet në ankand në mënyrë transparente.
- Çmimi referues bazohet në çmimin e mëparshëm e tregut të APEX-it.
- Për të shmangur kompensimin e tepërt të BRE-ve nga Homologu i KD-së kur çmimi i referencës tejkalon çmimin e paracaktuar.
- Mbështetja përfundimtare sipas një Kontrate për Diferencën (KD) do të përcaktohet përmes një procesi konkurrues dhe jo-diskriminues të tenderit (ankandit)
- KD-ja do të ketë një kohëzgjatje prej 15 vitesh.
- Homologu i KD-së është operatori përkatës i rrjetit me të cilin është lidhur instalimi.

#### **Hyrja në rrjet**

- Hyrja në rrjetet
  - ⇒ BRE-E kanë përparësi për hyrjen në rrjet.
  - ⇒ OST-ja dhe OSSH-ja garantojnë hyrjen në rrjetin e tyre në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë”.
  - ⇒ ERE do të miratojë rrjetin e duhur dhe masat operacionale të lidhura me tregun për të minimizuar ndërprerjet e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë elektrike.
- Lidhja me rrjetet
  - ⇒ OST-ja dhe OSSH-ja marrin hapat e duhur për të zhvilluar infrastrukturën e rrjetit T&SH, për të lejuar BRE-E.

#### **Matja neto**

Neni 15 - Skemat e matjes neto

- ⇒ Një NMV ose një klient familjar mund të instalojë një kapacitet deri në 500kW për prodhimin e BRE-E-ve për nevojat e tyre dhe mund të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes.
- ⇒ Klientët, bazuar në skemën neto të BRE, duhet të instalojnë me shpenzimet e tyre një matës me dy drejtime.
- ⇒ Bilanci neto dhe faturimi bëhen çdo muaj për secilën pikë matëse.
- ⇒ Ministria duhet të miratojë një procedurë të lehtësuar për autorizimet për lidhjen e projekteve të vogla të energjisë së rinovueshme me rrjetin.

#### **Certifikatat**

Neni 16 - Garancia e origjinës

- Me kërkesën e Prodhuesit të Energjive të Rinovueshme, ERE duhet të lëshojë garancinë e origjinës për çdo BRE-E-ve.

Garancia e origjinës në formatin standard dhe për një njësi të energjisë elektrike 1 MWh duhet të përcaktojë:

- ⇒ burimin e energjisë,
- ⇒ datën e fillimit e të përfundimit të prodhimit;
- ⇒ emrin, vendin, tipin dhe kapacitetin e stacionin ku është prodhuar energjia;
- ⇒ nëse prodhuesi ka përfituar prej mbështetjes me investime ose nga skema të tjera të mbështetjes në nivel kombëtar dhe masën e këtij përfitimi;
- ⇒ datën e autorizimit të stacionit dhe kohën kur është futur në punë;
- ⇒ datën, vendin e lëshimit të garancisë dhe një numër identifikimi unik.

- Garancia e origjinës mund të transferohet.
- ERE duhet të mbajë një regjistër elektronik të garancive të origjinës.
- ERE duhet të monitorojë lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës.
- Garancitë e origjinës duhet të lëshohen vetëm nëse prodhuesi siguron të gjitha informacionet përkatëse.
- Prodhuesit nuk i jepet mbështetje kur ai prodhues merr një garanci origjine për të njëjtin prodhim energjie nga burime të rinovueshme.


## **2.2.2 INICIATIVAT NË SHQIPËRI PËR SEKTORIN E ER-SË**

Projektet / nismat e renditura më poshtë janë zbatuar në kuadrin e programit Interreg IPA CBC.

**BLUE DEAL** synon të rrisë aktivitetin ndërkombëtar të grupeve dhe rrjeteve inovative të sektorit të ER-së, të zhvillojë lidhje dhe sinerji ndërmjet SME-ve, autoriteteve publike, institucioneve të dijes dhe shoqërisë civile dhe të krijojë Aleanca ndërkombëtare dhe rajonale për projektin “Blue Deal”.

Shqipëria, ishte aktori kryesor i laboratorit të dytë të testimit të projektit Blue Deal, i përqendruar në mundësitë e zhvillimit dhe zbatimit të teknologjive të ndryshme të energjisë blu në Portin e Durrësit, në Shqipëri.

Gjatë aktivitetit, u theksua pasuria e Shqipërisë në burimet e energjisë së rinovueshme ku u theksua energjia hidrike si burim kryesor; gjithashtu, është vërejtur një potencial i madh për prodhimin e energjisë elektrike nga era nga platformat offshore (Wind Offshore) dhe nga vjelja e energjisë së valëve.



<https://bluedealmed.eu/blue-deal-labs/albania-lab>

**Rinovimi i ndërtesave në Bashkinë e Dropullit.** Aktualisht, janë përgjendhur ndërtesat e synuara për rinovim. Në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, auditimet do të përfshijnë matjet e zarfit të ndërtesës dhe sipërfaqeve (dyshemetë, zonat e mureve, dritaret, çatitë, etj.), vlerësimin e vlerave aktuale të U-së, marrjen e faturave të detajuara dhe korrekte të energjisë të tre viteve të fundit (2018-2020), duke analizuar kushtet e ndërtimit (*kushtet fizikë të ndërtesës, sistemet teknike*) dhe analizat financiare. Konsiderohet gjithashtu përfitimi i energjisë elektrike të ndriçimit diellor për të përmirësuar EE-në dhe për të zvogëluar konsumin e energjisë elektrike dhe të karburantit, deri në masën kur është ekonomikisht e realizueshme.

**Projekti TARGET, Promovimi dhe Zbatimi i Eficiencës së Energjisë dhe BRE-ve në Ndërtesat Publike në Gjirokastrë.** Projekti do të zhvillojë ndërhyrje të përbashkëta të mirë përparimtare në drejtim të zvogëlimit të konsumit të energjisë në ndërtesat publike përmes:

- a. Shfrytëzimit të potencialit për kursim të energjisë dhe përmirësimit të efikasitetit të energjisë në sektorin e ndërtimeve, me ndërtesat e sektorit publik që janë një shembull për mobilizimin e gjithë ekonomisë,
- b. Stimulimit të shkëmbimit të njohurive ndërkufitare dhe ndërgjegjësimit në lidhje me efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike,
- c. Promovimit për përfshirjen e përbashkët të aktorëve të ndryshëm në planifikimin dhe zbatimin e qëndrueshëm të energjisë drejt një stoku ndërtimi me emetime të vogla karboni.

Projekti përdor Teknologjinë inteligjente të Informacionit dhe Komunikimit për krijimin e TARGET-it inovativ, interaktiv digjital që demonstron aplikime të qëndrueshme të energjisë, të cilat do të rrisin ndërgjegjësimin tek studentët.

**Projekti LED** - Drejt rrugës së përmirësimit të efikasitetit të energjisë në shkollat publike dhe përdorimit sa më shumë të burimeve të rinovueshme të energjisë. Objektivi i tij është të përmirësojë sjelljen e përdoruesve fundorë drejt efikasitetit më të lartë të energjisë, e cila si përfundim do të rezultojë në uljen e konsumit të energjisë në ndërtesat publike. Aktivitetet e projektit do të përmirësojnë efikasitetin e energjisë në ndërtesat publike, do të nxisin përdorimin e BRE-ve dhe do të rrisin ndërgjegjësimin social për çështjet e kursimit të energjisë.

Projekti **Bashkëpunimi ndërkufitar për efikasitetin e energjisë duke përdorur energjinë nga rrezatimi diellor** trajton ndikimet e mundshme drastike të ndryshimeve klimatike në mjedisin natyror dhe të krijuara nga njeriu. Projekti synon të tregojë se si një ndërhyrje e integruar e energjisë së mirë zhvilluar mund të arrijë objektivat mjedisore, ndërsa në të njëjtën kohë nxit rritjen ekonomike dhe çon në një zhvillim të drejtë ekonomik me nivele karboni të ulta.



[www.led-albaniagreece.com](http://www.led-albaniagreece.com)

Brenda projektit, do të zbatohen 2 projekte pilot në lidhje me instalimin e qelizave fotovoltaike në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza në Louros, Prevezë, dhe investimet për efikasitetin e energjisë elektrike në Bashkinë e Finiqit, si dhe një platformë për ndërgjegjësimin e efikasitetit të energjisë për publikun.

**Nisma për të rritur ndërgjegjësimin e bizneseve në qytetin e Korçës mbi investimet në energji dhe në ndërtimet e gjelbërta.** Kjo nismë analizon në detaje konsumin e energjisë në një ndërtesë, e cila përdoret si frigorifer për ruajtjen e frutave të zonës. Çdo biznes në rajonin e Korçës mund të zbatojë masa të efikasitetit të energjisë, për të ulur faturën mujore të energjisë elektrike. Ndërkohë, për herë të parë, është hartuar një raport që ofron të dhëna konkrete se si vlera e investimit në izolimin termik ose në panele diellore përkthehet në fatura të reduktuara të energjisë elektrike.



[www.gofundme.com/f/solar-energy-Kut](http://www.gofundme.com/f/solar-energy-Kut)

Fushata **“Energji diellore në Kutë (Solar in Kutë)”**, një iniciativë e organizatave partnere EcoAlbania, EuroNatur dhe Riverwatch, ka sjellë në vëmendjen e publikut historinë e komunitetit të Kutës në mbrojtjen e lumit Vjosa dhe aftësinë e këtij komuniteti për të prodhuar energji diellore në çatitë e ndërtesave, pa qenë nevoja të shkatërrohet lumi Vjosë. Si praktikë ose si model i parë i “komuniteteve të energjisë ose kooperativave të energjisë” në Shqipëri, projekti “Energji diellore në Kutë” do të krijojë energji në pronësi të komunitetit, që jo vetëm do të mbrojë integritetin e lumit Vjosë, por do të sjellë gjithashtu të ardhura shtesë për banorët e Kutës.

Ky projekt thekson rëndësinë e teknikave moderne si panelet PV të instaluar në çati për ruajtjen e mjedisit dhe se si energjia elektrike mund të prodhohet nga teknologji të tjera të energjisë së rinovueshme siç është energjia nga dielli.

**Zhvillimi i një komuniteti duke u mbështetur në energjinë inteligjente.** Sfida e përbashkët e propozimit dhe Programit është miratimi i standardeve evropiane në sistemin BRE, PRE dhe ES për sektorët publik dhe privat. Ekspertiza lokale do të krijohet duke përfshirë ndërgjegjësimin e trajnerëve me detyrën e zbatimit të energjisë inteligjente bazuar në standardet evropiane.

**Autoritetet Publike që Mbështesin rritjen e karbonit në nivele të ulëta në rajonet kufitare detare Evropiane - projekti “PASSAGE”.** Ky projekt synon të zhvillojë një tranzicion me

nivele karboni të ulët duke u shtrirë në 6 ngushtica evropiane dhe 5 rajone kufitare detare. Veprimi 3 i këtij projekti parashikon që qytetarët dhe komunitetet në të dy anët e Ngushticave të Otrantos dhe Korfuzit duhet të prodhojnë energji të pastër dhe të përballueshme. Komunitetet e Energjisë mund të promovojnë ekonominë dhe inovacionin e bazuar në shoqëri dhe solidaritetin në sektorin e energjisë, duke trajtuar varfërinë për energji, duke promovuar qëndrueshmërinë dhe inovacionin e energjisë, prodhimin, ruajtjen, vetë-konsumimin, shpërndarjen dhe furnizimin e energjisë elektrike, si dhe përmirësimin e pranimit lokal të BRE-ve dhe efikasitetin e energjisë elektrike në përdorimin fundor në nivel lokal dhe rajonal.

## 2.3 HARTËZIMI I GRUPEVE TË INTERESIT PËR ZHVILLIMIN E CEC-VE NË SHQIPËRI

Ndërkohë që ligjet dhe kornizat institucionale, si dhe mjetet shoqëruese të zbatimit ndryshojnë nga një sistem i energjisë në tjetrin, një proces i suksesshëm i komunitetit të energjisë varet nga angazhimi aktiv i palëve të interesit dhe shkëmbimi i informacionit midis palëve të interesit dhe vendim-marrësve. Autoriteti për të planifikuar dhe miratuar vendimet për investime në sektorin e energjisë elektrike i takon vendim-marrësve. Megjithatë, për procesin është shumë e rëndësishme përfshirja e palëve të interesit. Edhe pse palët e interesit të komunitetit nuk marrin vendime të detyrueshme ligjërish, ata kanë interesa të rëndësishme në sistemin e energjisë dhe si rrjedhim janë pikërisht ata që do të ndikohen nga këto vendime.


Siç u përmend edhe më lart, koncepti i komunitetit të energjisë është i ri në Shqipëri, dhe si i tillë, zbulimi i dinamikës së krijimit të një komuniteti të tillë dhe bërja e këtij komuniteti të qëndrueshëm, kërkon një analizë të detajuar të palëve të interesit për të gjithë aktorët kryesorë dhe përkatës.

### 2.3.1 QASJA PESTLE

Analiza PESTLE është një kornizë ose mjet që përdoret zakonisht në biznes dhe menaxhim për të analizuar mjedisin ku ata operojnë ose në rastet kur kanë plan të fillojnë operacione të reja.

Analiza politike shikon shkallën dhe ndikimet e pushtetit shtetëror në ekonomi. Faktorët ekonomikë përfshijnë ndikime të

drejtpërdrejta në kapacitetin ekonomik, qofshin ato të një organizate, sektori/ tregu të industrisë, apo shtet-komb. Faktorët socialë shqyrtojnë kontekstin shoqëror të këtyre institucioneve, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, analizat e popullsisë, demografinë dhe trendet kulturore. Faktorët teknologjikë lidhen me përparimin teknologjik, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin, teknologjitë e një pjese të vogël të tregut dhe automatizimin. Faktorët ligjorë marrin parasysh ligjet dhe politikat, duke përfshirë ligjet për mbrojtjen e konsumatorit, standardet e sigurisë dhe ligjet e punës. Faktorët e mjedisit janë të gjithë ata faktorë kritikë që kushtëzohen ose ndikohen nga çështjet mjedisore, vendndodhja gjeografike, ndryshimet globale të klimës, motit, etj.



**Figura 2:** Analiza PESTLE për zbatimin e energjisë së rinovueshme

Përvoja në BE tregon se komuniteti i energjisë është i zhvilluar në mënyrë të pabarabartë në Evropë. Që projektet të kenë sukses, këto iniciativa duhet të mbështeten nga ligjet dhe rregullat e mira. Projektet lulëzojnë në vendet ku është më e lehtë për t'i vënë në zbatim; ndërsa në vendet me pasiguri rregullatore, duhen aktivistë shumë të përkushtuar për të ecur përpara. Çka i shton më tej vështirësitë, ligjet kombëtare shpesh ndryshojnë. Që nga viti 2018 komuniteti i energjisë njihet nga ligji i BE-së, si pjesë e paketës legjislative që rregullon sistemin energjetik të BE-së. Kjo mund të ndryshojë rregullat e lojës për këdo që dëshiron të përfshihet në komunitetin e energjisë.

Më poshtë paraqitet lista e pengesave që mund të çojnë në dështimin e projekteve. Heqja e pengesave dhe zhvillimi i ideve për t'i kapërcyer ato hap pas hapi mund t'i bëjnë këto pengesa më pak të frikshme. Gjithashtu këto pengesa ka mundësi të jenë përballur më parë nga iniciativa të tjera të komunitetit të energjisë. Kërkimi i këshillave dhe mentorimi nga të tjerët janë gjithmonë thelbësorë për suksesin.




Foto @ pexels.com



**Tabela 3:** Pengesat ndaj komunitetit të energjisë

Fusha	Pengesat Potenciale
<p><b>Shoqërore, kulturore, politike dhe/ ose organizative</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e përvojës historike me kooperativa dhe aktivizëm qytetar të ngjashëm</li> <li>• Besimi i ulët në modelin bashkëpunues si një alternativë e vlefshme</li> <li>• Mungesa e mbështetjes politike nga përfaqësuesit vendorë</li> <li>• Nuk ka përvojë me krijimin e CEC-ve/kooperativave</li> <li>• Sfidat organizative - pengesat e fazës para-planifikuese</li> </ul>
<p><b>Ligjore, administrative, burokratike</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korniza ligjore e ndërlikuar, nivelet e larta të burokracisë për të marrë dokumentacionin përkatës (licencat, lejet, etj.)</li> <li>• Mungesa e strategjisë kombëtare të komunitetit të energjisë; mungesa e synimeve kombëtare për projektet e komunitetit të energjisë, të cilat më pas ndahen në Planet Vendore të Veprimit për Energjinë nga autoritetet vendore</li> <li>• Pengesat burokratike në lidhjen e rrjetit (procedurat e komplikuar të aplikimit, pasiguria e aprovimit, kostot, kërkon shumë kohë)</li> <li>• Nuk lejohet të operojë mikro-rrjetet - prodhimi, vetë-përdorimi, shitja brenda komunitetit, shitja te palët e treta - krahasuar me thjesht: shes atë në rrjet dhe e blen përsëri (shpesh me përfitime të ulëta financiare në komunitet - fitimet sërish merren nga kompani jashtë komunitetit, e cila hedh poshtë idenë për të mbajtur të ardhurat brenda komunitetit)</li> <li>• Mungesa e autoriteteve vendore mbështetëse dhe/ose agjencive të energjisë</li> <li>• Në përgjithësi, nuk ka skema mbështetëse për projektet e Burimeve të Rinovueshme të Energjisë</li> </ul>
<p><b>Teknike</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sfidat teknike - mungesa e njohurive të ekspertëve për të hartuar, planifikuar, prokuruar, zbatuar, porositur një projekt</li> <li>• Mungesa e njohurive të ekspertëve për funksionimin dhe mirëmbajtjen</li> <li>• Madhësia e projektit të energjisë</li> </ul>
<p><b>Financiare</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sfidat financiare në fazat fillestare të zhvillimit të projektit; aksesit në financa, grante, etj.</li> <li>• Pagesa të drejta dhe të sigurta për energjinë e prodhuar (tarifa të pamjaftueshme feed-in (FIT), FIT vetëm për erën, por jo për PV diellore, nuk ka Marrëveshje Blerje Energjie të standardizuar, nuk është e mundur nisja e palës së tretë)</li> <li>• Nxitje të pamjaftueshme për projektet e ngrohjes së rinovueshme: zëvendësimi i ngrohjes nga karburanti fosil me boilerë, biomasë ose pompat e nxehtësisë diellore termike,</li> <li>• Rregulla të ndërlikuara tatimore, pa përjashtime nga taksat</li> <li>• Në përgjithësi, nuk ka stimuj tatimorë për projektet e BRE-së, ka mungesë të garancive</li> </ul>
<p><b>Sfidat në grupe/ kooperativa të krijuara / me përvojë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zgjerimi i prodhimit të energjisë, i numrit të anëtarëve - si do të vlerësohen aksionet e anëtarësisë më të vjetër dhe asaj të re?</li> <li>• Ri-investim në instalimet ekzistuese</li> </ul>

Është e rëndësishme të përmendet se autoritetet vendore mund të kenë efekt transformues në mundësimin e modeleve të reja të biznesit në sektorin e energjisë, duke ndryshuar mënyrën e qeverisjes së sistemit energjetik, duke nxitur pjesëmarrje më të drejtpërdrejtë të komuniteteve vendore.

Nën-seksioni i mëposhtëm ofron një sërë rekomandimesh se si mund të mbështesin autoritetet iniciativat e komunitetit të energjisë.

## 2.4.6 REKOMANDIME

/// Sektori i energjisë deri më sot është drejtuar nga marrëdhënie të rrënjosura thellë midis prodhuesve tradicionalë të energjisë dhe qeverive, duke lënë pak hapësirë për pjesëmarrjen e qytetarëve (në të gjitha nivelet - politikë, prodhim, shpërndarje etj.). Propozohet që **projektet e komunitetit të energjisë të jenë më gjithëpërfshirëse të grupeve më të gjera njerëzish** nëse kërkohet të arrihet tërheqje më e madhe. Kjo mund të arrihet së pari përmes të kuptuarit të etikës dhe rëndësisë së pjesëmarrjes (drejtësia energjetike dhe demokracia), dhe praktikisht, përmes angazhimit me projekte ekzistuese të drejtuara nga qytetarët dhe angazhimit me lëvizjet aktiviste të drejtuara nga qytetarët.

/// Autoritetet vendore duhet të **kuptojnë që përgjigjet shpesh gjenden brenda komuniteteve të tyre** dhe se qytetarët tashmë janë duke marrë pjesë në disa projekte energjetike, në segmente të ndryshme. Përpjekja e përbashkët për t'u angazhuar me projektet ekzistuese është thellësisht e rëndësishme.

/// Autoritetet mund të **mbështesin iniciativa ekzistuese të drejtuara nga qytetarët dhe të inkurajojnë më shumë tërheqje** përmes:

o Prokurimit të energjisë së rinovueshme të prodhuar në vend nga komuniteti/projektet e energjisë bashkëpunuese.

o Zbatimit të një qasjeje bashkëpunuese për shpërndarjen e energjisë duke ofruar burime, kohën e zyrtarëve, udhëzime dhe marrëdhënie më të bashkuar midis komuniteteve dhe Autoriteteve Vendore.

o Kur kapaciteti i komunitetit dhe kapaciteti i Autoritetit Vendor është i ulët, të bashkëpunohet në ndërmarrje të përbashkëta.

/// Autoritetet Vendore mund të rrisin **dukshmërinë dhe njohjen e projekteve** përmes ndërëgjegjësimit midis anëtarëve të tyre të stafit dhe midis departamenteve për përfitimet e pjesëmarrjes së qytetarëve në projektet e komunitetit të energjisë.

Autoritetet vendore mund të përdorin gjithashtu marrëdhëniet e krijuara me mediat lokale dhe kombëtare, për të nxjerrë në pah iniciativat që zhvillohen brenda rajonit të tyre. Normalizimi i këtyre projekteve dhe identifikimi i iniciativave të drejtuara nga qytetarët si aktorët kryesorë në tranzicionin e energjisë mund të çojnë në përsëritjen e tyre.

/// Përqendrimi në **drejtësi mund të jetë filozofia kryesore drejtuese për komunitetin e energjisë** (të jesh i kujdesshëm për drejtësinë si në aspektin lokal ashtu edhe në atë global) dhe mund të kontribuojë për një skemë gjithëpërfshirëse dhe të drejtë. Qasjet ndaj pjesëmarrjes së qytetarëve duhet të orientohen tek ata që janë më pak të përfaqësuarit - dhe të jenë gjithëpërfshirëse të moshës, gjinisë, racës, pakicave dhe gjeografisë.

/// **Pronësia e komunitetit ose qytetarëve për iniciativat e energjisë** të zhvilluara nga autoritetet vendore do të thotë që qytetarët janë më të aftë të angazhohen me sistemet e energjisë. Pronësia mund të përfshijë aksione financiare në iniciativat/projektet e komunitetit të energjisë dhe lëvizjet e ri-komunalizimit dhe bashkë-projektimit (dhe ndjenjën e bashkëpronësisë) të vizioneve dhe projekteve të energjisë përmes proceseve të diskutimit.

/// Për një qytetari aktive dhe të angazhuar, gjithashtu nevojitet një Autoritet Vendor aktiv dhe i angazhuar. **Të gjithë anëtarët e stafit brenda Autoriteteve Vendore duhet të jenë të informuar rreth sfidave që mbart skema e komunitetit të energjisë** dhe nevojën për zbatimin e drejtë të skemës vetëm përmes miratimit të qasjeve bashkëpunuese.

/// Ka nevojë për shumë më shumë **bashkëpunim ndërdikasterial** brenda Autoriteteve Vendore, duke përfshirë të kuptuarin e çështjeve të tranzicionit të energjisë që shkojnë përtej të qenit vetëm një çështje 'mjedisore'.

/// **Angazhimi me shumë forma pjesëmarrjeje** - përfshirë aktivizmin e qytetarëve, protestat dhe fushatat që pasqyrojnë shqetësimet e qytetarëve - është thelbësore për të ushqyer marrëdhëniet midis autoriteteve vendore dhe publikut, për të nxitur besimin midis të dy palëve dhe për të inkurajuar marrëdhënie të hapur diskutimi midis të dyve.

/// **Autoritetet Vendore duhet të jenë më të afrueshëm** - miratimi i politikave me dyer të hapura dhe lejimi i qytetarëve të merren me zhvillimet shumë më lehtësisht. Kjo mund të bëhet përmes kërkimit aktiv të nismave dhe lëvizjeve ekzistuese dhe ftesës së më shumë qytetarëve për të hartuar politikatat.

---

/// **Miratimi i strategjive të qeverisjes pjesëmarrëse** që lejojnë kontributin e qytetarëve në strategjitë e vizionin për të gjithë qytetin dhe/ose të gjithë rajonin.

/// Autoritetet Vendore duhet të luajnë rol specifik për t'u siguruar që pikëpamjet dhe shpresat e qytetarëve të tyre të futen në **planet kombëtare, rajonale dhe vendore**, veçanërisht ato të lidhura me energjinë dhe klimën. Nëse kjo nuk ndodh, ato duhet të luajnë rol në rritjen e ndërgjegjësimit për këto plane, duke u siguruar që qytetarët të mund të angazhohen dhe të kontribuojnë në arritjen dhe tejkalimin e qëllimeve të përcaktuara për secilin shtet komb.

/// **Idetë e zhvilluara përmes proceseve krijuese mund të çojnë në një audiencë më të gjerë pjesëmarrëse.** Jo të gjithë qytetarët mund të jenë të etur për të qenë pjesë e strategjive vendore të energjisë, nëse këto të fundit ofrohen në mënyrë tradicionale, strukturore - por ato mund të shoqërohen me vizion më të gjerë të zhvillimit shoqëror, lëvizshmërisë, pasurisë vendore dhe shëndetit, kulturës dhe artit.

/// Nevojiten **analiza të mëtejshme të hollësishme dhe kërkime afatgjata** për të provuar përparimet në pjesëmarrjen e autoriteteve vendore në skemën e komunitetit të energjisë.

## 2.5 SKEMAT RREGULLATORE DHE FINANCIARE SI DHE KORNIZA PËR CEC

Mbështetja publike është thelbësore për projektet e energjisë për të arritur objektivat e BE-së dhe vendit për energjinë e rinovueshme dhe reduktimin e GS-ve, si dhe për të përmbushur objektivat e ardhshëm të klimës dhe energjisë. Projektet e komunitetit të energjisë në të gjithë Evropën operojnë në kontekste shumë të ndryshme ligjore. Në shumë vende të BE-së, legjislacioni ekzistues nuk ofron mbështetje të mjaftueshme, dhe në disa raste e pengon në mënyrë aktive, pronësinë e komunitetit. Në të kundërt, disa vende kanë rregullore specifike që mundësojnë pronësinë e qytetarëve dhe përfshirjen në projekte të energjisë së rinovueshme. Në kontekstin shqiptar, synohet të sigurohet një informacion me bazë të gjerë për sa i përket legjislacionit, rregulloreve dhe politikës për projektet e komunitetit të energjisë dhe të hartohen rekomandime për kornizën rregullatore dhe skemat financiare.

### 2.5.1 STRUKTURAT LIGJORE PËR KOMUNITETET E ENERGJISË

Modele të ndryshme të qeverisjes mundësojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në projekte energjitike. Në varësi të formës ligjore të zgjedhur, ato mund të ndryshojnë për sa i përket strukturës së qeverisjes, vendimmarrjes dhe përgjegjësisë (Tabela më poshtë). Për shembull, ato mund të jenë plotësisht në pronësi të komunitetit ose të zhvilluara në bashkëpunim me aktorë publikë ose komercialë (pronësi e përbashkët) (Yildiz et al., 2015). Për më tepër, projektet e menaxhuara nga komuniteti mund të marrin forma të ndryshme, duke filluar nga kooperativat e mëdha, në sistemet ishullore jashtë rrjetit.

**Tabela 4:** Strukturat e mundshme ligjore për komunitetet e energjisë

Struktura Ligjore	Përshkrimi
<b>Kooperativat energjetike</b>	Kjo është forma më e zakonshme dhe me rritje të shpejtë të komuniteteve të energjisë. Nga kjo lloj pronësie përfitojnë kryesisht anëtarët e saj. Është e famshme në vendet ku burimet e rinovueshme dhe komuniteti i energjisë janë relativisht të përparuar.
<b>Partneritet i kufizuar</b>	Partneriteti i lejon individët të shpërndajnë përgjegjësitë dhe të nxjerrin fitime duke marrë pjesë në komunitetin e energjisë. Qeverisja zakonisht bazohet në vlerën e aksioneve të secilit partner, që do të thotë se jo gjithmonë ofrojnë një anëtar - një votë.
<b>Trustet dhe fondacionet e komunitetit</b>	Qëllimi i tyre është të prodhojnë vlera shoqërore dhe zhvillim vendor më shumë sesa përfitime për anëtarët individualë. Fitimet përdoren për komunitetin, edhe kur qytetarët nuk kanë mjetet për të investuar në projekte (për kompanitë në të mirë të publikut).
<b>Shoqatat e banesave</b>	Shoqatat jofitimprurëse që mund të ofrojnë përfitime për qiramarrësit në strehimin social, megjithëse mund të mos përfshihen drejtpërdrejt në vendimmarrje. Këto forma janë ideale për adresimin e varfërisë energjetike.
<b>Ndërmarrjet jofitimprurëse në pronësi të klientëve</b>	Strukturat ligjore të përdorura nga komunitetet që merren me menaxhimin e strukturave të rrjetit të pavarur. Ideale për rrjetet e ngrohjes qendrore të komunitetit, të zakonshme në vende si Danimarka.
<b>Partneritetet publike-private</b>	Autoritetet Vendore mund të vendosin të hyjnë në marrëveshje me grupet e qytetarëve dhe bizneset për të sjellë sigurimin e energjisë dhe përfitime të tjera për një komunitet.
<b>Ndërmarrjet e shërbimeve publike</b>	Kompanitë e shërbimeve publike drejtohen nga bashkitë, të cilat investojnë dhe menaxhojnë ndërmarrjen në emër të taksapaguesve dhe qytetarëve. Këto forma janë më pak të zakonshme, por janë veçanërisht të përshtatshme për zonat rurale ose të izoluara.


Burimi: Roberts, Bodman dhe Rybski, 2014; Hanna, 2017; REN21, 2016

Shumica e iniciativave të drejtuara nga qytetarët janë kooperativa. Kooperativat janë një lloj i ndërmarrjeve shoqërore dhe ekonomike që u mundëson qytetarëve të zotërojnë dhe menaxhojnë në mënyrë kolektive projektet energjetike. Banorët vendas, ose banorët nga zona fqinje mund të investojnë në prodhimin e rinovueshëm duke blerë aksione për të financuar një projekt (Walker, 2008). Në disa raste, qytetarët gjithashtu mund të konsumojnë dhe ndajnë energji.

Në një kooperativë, shpërndarja e fitimeve është e kufizuar dhe tepricat investohen sërish për të mbështetur anëtarët e saj dhe/ose komunitetin. Alokimi i të ardhurave nga projektet rregullohet nga statutet e kooperativës, të cilat lidhen me qëllimin e saj kryesor. Ndonjëherë ato mund të shpërndahen ndërmjet anëtarëve përmes dividendëve të kufizuar. Nisma të tjera mund të ofrojnë përfitime të energjisë në formën e çmimeve më të ulëta të energjisë. Kooperativat bazohen në qeverisjen demokratike - d.m.th., vendimet e marra në parimin ‘një anëtar - një votë’.

## 2.5.2 SKEMAT FINANCIARE DHE KORNIZA RREGULLATORE

Koncepti i CEC-së është i ri në Shqipëri, dhe për pasojë diskutimi i mëposhtëm i skemave financiare dhe korniza rregullatore bëhet bazuar në paraqitjen e një sërë idesh dhe rekomandimesh mbi pozicionin dhe rolin që duhet të luajë secila prej palëve të interesit në këtë proces. Rekomandimet e paraqitura më poshtë kanë rëndësi në mbështetjen e rritjes së komunitetit të energjisë. Rekomandimet “thelbësore” janë parakushtet themelore për mbështetjen e komunitetit të energjisë dhe kërkojnë veprime të menjëhershme



**Figura 4:** Skema fillestare për CEC

Burimi: Autori

### 2.5.3 SKEMA KORNIZË PËR CEC

Skemat e CEC-ve duhet të hartohen për vazhdimësi afatgjatë të qëndrueshmërisë. Më poshtë janë përmbledhur nevojat e rëndësishme kornizë, të cilat duhet të merret parasysh.

⇒Legjislacioni dhe politika kombëtare nuk duhet të përcaktojnë “komunitetin e energjisë” në mënyrë kufizuese. Ato duhet të promovojnë një gamë të gjerë modelesh për pronësinë e qytetarëve dhe pjesëmarrjen në prodhimin dhe/ose përdorimin e energjisë së qëndrueshme.

⇒Kornizat ligjore duhet të sigurojnë të paktën ‘pronësinë’ e pjesshme të komunitetit dhe ‘pjesëmarrjen’ efektive në projektet e energjisë komerciale, qoftë me statut ose me praktikën më të mirë të industrisë.

⇒Projektet e komunitetit të energjisë nuk duhet t’i nënshtrohen proceseve konkurruese të ofertave për të marrë mbështetje për operim; në vend të kësaj, ato duhet të kenë të drejtën të marrin tarifa FiT (feed-in).

⇒Legjislacioni kombëtar duhet të stimulojë projekte të komunitetit të energjisë bazuar në “vetë-mjaftueshmëri” (p.sh. marketing i drejtpërdrejtë dhe prodhim për vetë-konsum), për shembull përmes investimeve dhe lehtësimit të taksave, ose uljes së tarifave për konsumin e energjisë.

⇒Autoritetet (në të gjitha nivelet) duhet të sigurojnë mbështetje financiare (p.sh., grante për kredi, garanci ose mundësi kredish të lira) për hetime paraprake dhe punë në projekte të komunitetit të energjisë.

⇒Autoritetet vendore, me mbështetjen e autoriteteve kombëtare nëse është e përshtatshme, duhet të përdorin kompetencat e planifikimit për të kërkuar integrimin e burimeve të rinovueshme dhe efikasitetin e energjisë në ndërtesa publike, të reja dhe të rinovuara, të modernizojnë kërkesat për projektet e komunitetit të energjisë drejt “one-stop-shop” dhe të ofrojnë udhëzime për të ndihmuar në kërkimin e rregulloreve.

⇒“Drejtimi i Komunitetit” duhet të jetë një e drejtë konkrete për vendimet e planifikimit në lidhje me projektet e energjisë.

⇒Ligjet duhet të sigurojnë akses të barabartë në rrjet për projektet e komunitetit të energjisë; kostot e përforcimit duhet të bien mbi operatorin e rrjetit si pjesë e një detyre të vazhdueshme për të siguruar integrimin e burimeve të rinovueshme dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit.

⇒Legjislacioni kombëtar nuk duhet të vendosë kërkesa tepër kufizuese për projektet e komunitetit të energjisë që dëshirojnë të bëhen pronarë/operatorë të infrastrukturës së rrjetit ose furnizues plotësisht të licencuar të energjisë së gjelbër.

#### **Rekomandimet specifike për Skemat e Mbështetjes Financiare**

##### **↳ Mbështetja e projekteve të komunitetit të energjisë për të prodhuar dhe eksportuar energji**

o Skemat kombëtare të mbështetjes duhet të lejojnë që projektet më të vogla të komunitetit të energjisë të kenë të drejtën për të marrë tarifa FiT (feed-in) me çmim fiks. Më së paku, projektet e komunitetit të energjisë nuk duhet t’i nënshtrohen proceseve konkurruese të tenderave për të marrë mbështetje për operimin e tyre. Nëse ekzistojnë skemat konkurruese të ofertave, të tilla si tenderimet ose ankandet, ato duhet të përmbajnë masa mbrojtëse rregullatore për t’u siguruar që zhvilluesit më të mëdhenj dhe prodhuesit tradicionalë të tregut të energjisë të mos përfitojnë në kurriz të projekteve të komunitetit të energjisë, duke rezultuar në nxjerrjen e tyre jashtë tregut të energjisë.

o Për të ruajtur qëndrueshmërinë afatgjatë dhe drejtësinë sociale, skemat FiT (feed-in) duhet të jenë të përshtatura me kalimin e kohës, dhe të ndahen në mënyrë të barabartë midis të gjithë konsumatorëve të energjisë në përputhje me parimin: ndotësi paguan.

o Nëse largohet nga subvencionet e drejtpërdrejta për stacionet e komunitetit të energjisë, legjislacioni kombëtar duhet të promovojë stimuj alternativë ku përfshihen kursimet e realizuara në faturat e energjisë ose taksat e tjera (p.sh. skemat e matjes neto), ose duke stimuluar projekte të komunitetit të energjisë të vetë-mjaftueshme, që tregtojnë drejtpërdrejt energjinë e tyre në klientët pranë. Këto masa mund të ndihmojnë në promovimin e stabilitetit të rrjetit, ndërgjegjësimin më të madh për energjinë dhe uljen e kostove dhe konsumit të energjisë.

##### **↳ Mbështetja për investime në komunitetin e energjisë**

o Investimet me përgjegjësi shoqërore dhe sasitë më të vogla të investimeve në komunitetin e energjisë nga familjet duhet të mbështeten përmes rregullave preferenciale të taksave, për shembull përmes përjashtimeve ose uljeve të tatimit mbi të ardhurat. Autoritetet kombëtare dhe vendore gjithashtu duhet të ofrojnë lehtësime të veçanta tatimore për ndërtimin e stacioneve të komunitetit të energjisë.

o Autoritetet duhet të krijojnë skema të dhënies së granteve për kredi për të mbështetur projektet e komunitetit të energjisë në hetime paraprake dhe punime (p.sh., në studimet e fizibilitetit, marrjen e lejes së planifikimit). Rregullat dhe procedurat kombëtare duhet të lejojnë që fondet strukturore ose fondet e tjera të përdoren për krijimin e mekanizmave të tillë mbështetës. Autoritetet kombëtare dhe/ose vendore duhet të përdorin gjithashtu institucione financiare publike për të siguruar projekte të komunitetit me garanci të veçanta të huasë, ose mundësi kredish të lira. Kjo mbështetje ndihmon në shfrytëzimin dhe zhbllokimin e investime të tjera private në energjinë e rinovueshme dhe për të garantuar siguri shtesë të investitorëve.

#### ↳ **Integrimi i komunitetit të energjisë në kornizat e planifikimit hapësinor**

o Dokumentet e planifikimit në nivel kombëtar duhet të sigurojnë një bazë të fortë për promovimin e komunitetit të energjisë në nivele rajonale dhe vendore. Kur krijohen kornizat e planifikimit hapësinor rajonal ose vendor, këto duhet t'i japin përparësi mbështetjes për projektet e komunitetit të energjisë para llojeve të tjera të zhvillimit të energjisë.

o Në nivel bashkiak, komuniteti i energjisë duhet të integrohet në kornizat rregullatore vendore, për shembull përmes kërkesave për të integruar kapacitetin e prodhimit të rinovueshëm në ndërtesat e reja ose të rinovuara. Për më tepër, autoritetet vendore duhet ta bëjnë sa më të lehtë që individët dhe grupet e komunitetit të vlerësojnë qëndrueshmërinë e zhvillimit të energjisë së rinovueshme, për shembull përmes krijimit të hartave diellore.

#### ↳ **Procedurat e thjeshtuara të lejimit për projektet individuale të komunitetit të energjisë**

o Kërkesat për leje për projektet e energjisë duhet të bazohen në shkallën dinamike sipas madhësisë. Kjo duhet të përfshijë procedura të thjeshtuara për projekte më të vogla të komunitetit të energjisë dhe kërkesa minimale për mikro-stacionet, ose përmes para-aprovimit ose njoftimit të thjeshtë për klasat e specifikuar të stacioneve. Kur ka kërkesa shtesë, ato duhet të bëhen të ditura përmes qasjes “one stop shop”.

o Rregullat për vlerësimin dhe reagimin ndaj ndikimeve nga stacionet e komunitetit të energjisë (p.sh. zhurma, pamja, dridhja e hijes, ndikimet në zonat e mbrojtura) duhet të përcaktohen sa më qartë që të jetë e mundur,

dhe të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e besimit dhe legjitimitetit të publikut në procesin e planifikimit dhe të promovojë sigurinë e investitorëve. Këto rregulla duhet të mbështeten gjithashtu nga udhëzime të qarta dhe shërbime mbështetëse nga autoritetet vendore për të ndihmuar qytetarët e zakonshëm në gjetjen e kërkesave ligjore.

o “Drejtimi i Komunitetit” duhet të jetë e drejtë konkrete për procesin e miratimit të planifikimit për projektet e komunitetit të energjisë. Kjo mund të ndihmojë për të treguar se projekti ka mbështetje nga komuniteti vendor, duke rritur legjitimitetin e këtyre projekteve.

#### ↳ **Angazhimi i qytetarëve**

o Në hartimin e kornizave të planifikimit hapësinor për zhvillimin e komunitetit të energjisë, duhet të sigurohen në nivelin e duhur udhëzimet në lidhje me masat minimale të pjesëmarrjes të kërkuara nga ligji dhe mënyrat për t'i tejkaluar ato, për të siguruar transparencën dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen nga të gjithë sektorët e shoqërisë. Kjo mund të rrisë legjitimitetin, të sigurojë llogaridhënien demokratike dhe të ofrojë siguri shtesë për projektet individuale më vonë.

o Për planifikimin e projekteve individuale, autoritetet vendore ose rajonale duhet të zhvillojnë masa (të mbështetura nga udhëzime dhe rekomandime) që tejkalojnë kërkesat minimale ligjore për pjesëmarrjen e publikut dhe aksesin në informacion. Këto procese duhet të sigurojnë një proces diskutimi me të gjithë palët përkatëse të interesit, në vend vetëm të konsultimit. Aty ku është e mundur, autoritetet vendore duhet të marrin në konsideratë si të përfshijnë grupe me të drejta të reduktuara që nuk marrin pjesë zakonisht në procesin e planifikimit (p.sh., të moshuarit, grupet e pakicave etnike).

## 3. MODELE POTENCIALE BIZNESI PËR CEC

Kjo pjesë përshkruan shkurtimisht disa nga praktikat më të mira të komuniteteve qytetare të energjisë në nivel rajonal dhe BE.

### 3.1 MODELET, TEKNOLOGJITË, PILOTIMET EKZISTUESE EVROPIANE

#### DRIN Fojnica (Bosnje-Hercegovinë)

Fojnica është një qytet i vogël (12.400 banorë në 2013) në Bosnje-Hercegovinën qendrore i njohur për gjetjet e shumta arkeologjike, monumentet historike dhe burimet natyrore.

DRIN është shkurtesa për Institutin e kujdesit të personave me aftësi të kufizuara mendore në Fojnica. Instituti është krijuar në 1955. Ai përfaqëson një qendër për kujdesin shoqëror dhe shëndetësor, trajtimin dhe rehabilitimin e zgjatur, trajnimin për jetë të pavarur të njerëzve me çrregullime të zhvillimit dhe personave me probleme të shëndetit mendor. DRIN akomodon pothuajse 500 persona me aftësi të kufizuara mendore dhe është vend pune për gati 250 të punësuar.



Foto @ REIC NGO

Ideja për të investuar para për kolektorët diellorë të ujit të nxehtë që ishin instaluar në çatinë e DRIN u krijua nga Qendra Rajonale e Arsimit dhe Informimit (QRAI). Energjia diellore, ndryshe nga lëndët djegëse fosile, është në dispozicion në masë të pakufizuar dhe nuk prodhon gazra të dëmshme. Duke instaluar kolektorë diellorë, është e mundur të kursehet deri në 60% të kostove që lidhen me përgatitjen e ujit të nxehtë, i cili gjithashtu do të ketë një efekt pozitiv në mjedis. Në tetor 2018 QRAI filloi fushatën e parë të financimit të fondeve të energjisë së rinovueshme në historinë e Bosnje-Hercegovinës. Ky ishte gjithashtu hapi i parë drejt tranzicionit energjetik në një komunitet vendor në Bosnje-Hercegovinë.

#### Križevačkisunčanikrovovi (Kroaci)

Križevci është një qytet i vogël në pjesën veriore të Kroacisë me 21.700 banorë.



Panele Diellore ne qytetin Križevci, Kroaci, Foto @ ZEZ (GreenEnergy cooperative)

Centrali i parë diellor në Kroaci i financuar tërësisht nga qytetarët u instalua në 2018. Ky termocentral PV “Križevačkisunčanikrovovi” ndodhet në çatinë e ndërtesës të Qendrës së Zhvillimit të Bashkisë dhe godinës administrative të Parkut Teknologjik me konsum të drejtpërdrejtë në vend. Nisma ishte projekti i përbashkët i udhëhequr nga Qyteti i Križevci dhe ZEZ (GreenEnergy Cooperative), një nga kooperativat e para të energjisë në Kroaci. ZEZ dhe Qyteti i Križevci udhëhoqën fushatën për energjinë e qytetarëve gjatë vitit 2018. Ata patën tre prezantime në 20 ditë. Në prezantimin e parë publik ata kishin vetëm 7 pjesëmarrës dhe 70 pjesëmarrës në atë të fundit. Financimi i centralit filloi me një fushatë për mbledhjen e fondeve, e cila përfshinte 53 investitorë me një investim mesatar prej 500 EUR. Fushata arriti të mbledhë shumën totale të parave të nevojshme në vetëm 10 ditë.

Meqenëse interesi ishte i madh, centrali PV (30kW) u instalua menjëherë. Ai u financua tërësisht nga qytetarët e Križevci dhe të gjithë njerëzit e tjerë që dëshironin të investonin. Projekti do të kursejë rreth 55 ton CO<sub>2</sub> çdo vit pasi prodhimi është planifikuar për rreth 50.000 kWh në vit. Me sistemin e ri diellor, Biblioteka e Qytetit do të jetë në gjendje të kursejë para dhe të sigurojë kthimin e investimit për qytetarët-investitorë.



### **Kooperativa e Energjisë “Kooperativa e centralit të energjisë diellore e Sllovenisë - ZSES” (Slloveni)**

Ptuj është qyteti më i vjetër në Slloveni. Ndodhet në pjesën verilindore të vendit në lumin Drava dhe ka 18,000 banorë. Tranzicioni i energjisë në Slloveni filloi në vitin 2014 kur u themelua kooperativa. Kooperativa e Energjisë ZSES në Ptuj u krijua nga pronarët e 13 centraleve të energjisë diellore në asamblenë e përgjithshme themeluese. Deri në vitin 2020, Kooperativa e Energjisë mbledhi 169 centrale diellore fotovoltaike nga e gjithë Sllovenia.

Çdo central përfaqëson një anëtar të Kooperativës. Të gjithë anëtarët (qofshin persona fizikë apo juridikë) kanë të njëjtin status. Kooperativa e Energjisë shet energji nga rrjeti në bursë dhe prodhon të ardhura prej 100.000 EUR në vit. Panelet diellore (kapaciteti i plotë i instaluar 9 MW deri në vitin 2018) janë instaluar në çatitë e kopshteve, shkollave, sallave të prodhimit dhe ndërtesave të banimit. Pas 7-8 vjetësh, centralet bëhen pronë e mjediseve të personit fizik/personit juridik të objektit në çatitë e të cilit janë vendosur impiantet.

### **Skema e Fermës Komunale diellore fotovoltaike (Maltë)**

Në rajonin Rabat të Maltës, çatia e Rezervuarit Tal-Fiddien është shndërruar në një fermë diellore fotovoltaike që fton investime nga qytetarë të cilët mund të mos jenë në gjendje të investojnë në PV diellore në pronat e tyre pasi nuk kanë sipërfaqe të përshtatshme (siç janë apartamentet në katet përdhese).



Foto @ 2021 Hili Company

Instalimi përmban 4,000 panele PV që arrijnë gjithsej 999 kWp (maksimumi në kilovat - prodhimi i energjisë elektrike i një sistemi PV kur është me kapacitet maksimal). Banorët mund të blejnë midis 1-3 kWp me një çmim prej 1,500 EUR për kWp dhe në këmbim të tyre ata përfitojnë nga tarifa FiT prej 15 cent për kWh të prodhuar për gjashtë vitet e para, dhe 10,5 cent për pjesën e mbetur të njëzet viteve qiradhënie.

Skema u krijua nga Agjencia Malteze e Energjisë dhe Ujit për të

rritur prodhimin e energjisë së rinovueshme në ishull. Pavarësisht fillimit të ngadaltë, skema ka qenë shumë e suksesshme, me të gjitha 999 kWp të blera brenda nëntë muajve nga fillimi, nga rreth 400 familje.

## **3.2 IDE TË REJA DHE IDENTIFIKIMI I MODELEVE MË TË FUNDIT TË BIZNESIT TË CEC NË SHQIPËRI**

Aktivitet kryesor në fillim të çdo biznesi të ri është zhvillimi i një modeli të qëndrueshëm biznesi. Thelbi i këtij modeli biznesi qëndron në përcaktimin se si ndërmarrja ua çon vlerën klientëve, i josh klientët të paguajnë për vlerën dhe i shndërron ato pagesa në fitim. Mund të merren parasysh modelet e gatshme të biznesit bazuar në paketa teknologjike ose shërbime të ofruara, si në rastin e një operatori të rrjetit me bazë komuniteti. Preferohet që modeli i biznesit me qëllim angazhimit të qëndrueshëm të komunitetit të jetë agnostik i teknologjisë. Për më tepër, që të ndahet biznesi i angazhimit të komunitetit nga një hobi, duhet të identifikohen përfitimet e vërteta.

Para se të analizojmë çështjet teorike dhe praktike në lidhje me modelin e biznesit të CEC-ve, ky kapitull ofron informacion mbi dy tema, posaçërisht të lidhura me Shqipërinë, dhe të cilat ne besojmë se do të sigurojnë terren të mirë për zhvillimin e projekteve të CEC-ve së shpejti. Këto tema janë a) Fondi i Komunitetit i ofruar nga Bashkia e Tiranës, dhe b) Ndërmarrjet Sociale në Shqipëri.

### **3.2.1 BASHKIA TIRANË – FONDI I KOMUNITETIT**

Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës ka miratuar Vendimin nr. 14, datë 20.02.2017 “Për miratimin dhe zbatimin e programit ‘Fondi i Komunitetit’”. Ai synon të nxisë bashkëpunimin efektiv midis qytetarëve për të përmirësuar infrastrukturën e blloqeve të banimit dhe për të ruajtur ambientet në pronësi të përbashkët. Përmes një skeme fondi të vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, banorët e lagjeve të ndryshme (bashkëpronarë të objekteve të strehimit) të kryeqytetit mund të organizohen së bashku nën drejtimin e Administratorëve për të marrë bashkëfinansim për projektet e infrastrukturës që trajtojnë një problem specifik në komunitetin e tyre. Përmes këtij programi, ata synojnë të arrijnë një sërë objektivash të cilat nuk kanë të bëjnë vetëm me përmirësimin e mjediseve të përbashkëta, por gjithashtu synojnë të ndryshojnë mentalitetin e bashkëpunimit midis qytetarëve dhe institucioneve publike.

### **Objektivat Specifike të Programit**

- Mbështetje financiare për komunitetet në nevojë dhe të cilët dëshirojnë të përmirësojnë objektet e tyre të përbashkëta.
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe hapësirave urbane të kryeqytetit.
- Nxitja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive në çështjet që lidhen me mirëfunksionimin e bashkëjetesës në komunitet.
- Nxitja e bashkëpunimit pozitiv midis komuniteteve dhe autoriteteve vendore.
- Mbështetja e iniciativave të komunitetit të qytetarëve për promovimin dhe kultivimin e mentalitetit të bashkëpunimit.
- Edukimi qytetar për mbrojtjen e zonave të përbashkëta dhe përdorimin e mirë të financave të tyre.
- Përsheptimi i procedurave për punësimin dhe regjistrimin e Administratorëve.

### **Aplikantët e kualifikuar**

Administratorët në emër të Asambleve dhe në bashkëpunim me anëtarët e kryesisë, aplikojnë me shkrim në bashki me një Formular aplikimi dhe dorëzojnë dokumentet përkatëse në zyrat e Njësisë Administrative përkatëse.

### **Kriteri i bashkëfinancimit**

Një nga kriteret për ndarjen e fondit është kriteri i bashkëfinancimit. Bashkëfinancimi duhet të jetë së paku 50% e fondit total (fondi total = fondi i Bashkisë së Tiranës + fondi i mbledhur nga bashkëpronarët).

### **Llojet e projekteve të pranueshme për bashkëfinancim**

1. Mirëmbajtja e fasadave: Kjo përfshin lyerjen dhe suvatimin e fasadave, etj.
2. Punimet për eliminimin e pengesave arkitekturore dhe përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara.
3. **Projekte për ruajtjen/efiçencën e energjisë ose me ndikim pozitiv në mjedis: Kjo përfshin izolimin termik të fasadave, instalimin e paneleve diellorë, etj.**
4. Mirëmbajtja e çatave: Kjo përfshin hidroizolimin dhe izolimin termik të çatave, etj.
5. Mirëmbajtja e shesheve (hapësirat publike dhe/ose në bashkëpronësi, në funksion të blloqeve të banimit, terreneve të lojërave dhe fushave ekzistuese të sporteve). Këto përfshijnë rehabilitimin e shesheve (pallakat e trotuareve, riparimin e asfaltit ose shtresave të ndryshme), mbjelljen e barit/shkurreve/pemëve dekorative, instalimin e stolave/zonave të pushimit, lyerjen e parkingjeve dhe sinjalistikës brenda bllokut të banimit, riparimin e ndriçimit publik ekzistues, etj.



Foto @ [www.monosi-thermomonosi.com](http://www.monosi-thermomonosi.com)

### Cikli i Zbatimit

Procesi i aplikimit, përzgjedhjes dhe zbatimit të projekteve të miratuara bëhet përmes një procedure transparente dhe konkurruese, me hapa të përcaktuar në dokumentet standarde të aplikimit dhe në bashkëpunim të vazhdueshëm midis palëve (shih Figurën 7 më poshtë).



**Figura 5:** Cikli i zbatimit të programit “Fondi i Komunitetit”

(Burimi: Bashkia Tiranë)

## 3.2.2 NDËRMARRJET SOCIALE NË SHQIPËRI

Në vitin 2016, qeveria shqiptare miratoi Ligjin 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”. Tabela më poshtë jep një përmbledhje të kornizës ligjore për ndërmarrjet shoqërore.

**Tabela 5:** Korniza ligjore për ndërmarrjet sociale në Shqipëri

Akti ligjor	Përshkrim i shkurtër
Ligji Nr. 65/2016 “Për Ndërmarrjet Sociale në Republikën e Shqipërisë”	Ky ligj synon të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve të cenueshme
VKM Nr. 716, datë 1.12.2017 “Për përcaktimin e procedurave për kryerjen e veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”	VKM parashikon që Ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, përmes inspektoratit përgjegjës për çështjet sociale, ushtron kontrollin, në mënyrë që të sigurojë pajtueshmëri me legjislacionin për ndërmarrjet sociale nga subjektet zbatuese.
VKM Nr. 16, datë 12.1.2018 “Për miratimin e listës së aktiviteteve që ushtrojnë ndërmarrjet sociale”	Sipas kësaj VKM-je, veprimtaria e ndërmarrjeve sociale përfshin fushën e shërbimeve sociale, shëndetësore, kulturore dhe arsimore, promovimin e turizmit dhe mbrojtjen e mjedisit, si dhe aktivitetet e ndërmjetësimit dhe kualifikimit të punësimit.
VKM Nr. 789/2018 “Për krijimin e një fondi në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes përmes subvencioneve për ndërmarrjet sociale”	Kjo VKM synon të krijojë Fondin e Mbështetjes së Ndërmarrjeve Sociale, i cili synon të mbështesë njësinë ekonomike që është njohur me statusin e ndërmarrjes sociale.
VKM Nr 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”	Ky vendim parashikon kategorizimin dhe mbështetjen e personave dhe grupeve të pafavorizuara përmes punësimit dhe lehtësimit të aksesit të tyre në tregun e punës.
Urdhër Nr. 636, datë 3.9.2018 “Për miratimin e llojit të rregullores së funksionimit të ndërmarrjeve sociale”	Rregullorja synon të përcaktojë rregullat për funksionimin e brendshëm të ndërmarrjeve sociale, përshkrimin e rregullave të përgjithshme të punës, standardet e etikës si dhe parimet themelore të administrimit financiar dhe mënyrën e menaxhimit të aseteve në një ndërmarrje shoqërore.
Udhëzim Nr. 602, datë 1.8.2018 “Për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale”	Siguron një listë të detajuar të procedurave që duhen ndjekur dhe dokumenteve që duhet të dorëzohen
Udhëzim Nr. 2, datë 4.1.2019 “Për krijimin e regjistrit të ndërmarrjeve shoqërore”	Jep detaje se si të vendoset dhe mirëmbahet regjistri, çfarë informacioni nevojitet, etj.

**Udhëzim Nr. 677, datë 27.9.2018**  
**“Për përcaktimin e formularëve, afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për aktivitetet e ushtruara dhe kategoritë e personave të punësuar në ndërmarrjet sociale”**


Siguron kërkesat e raportimit dhe formatin e raportimit

Burimi: Vetë-përpunimi (listë e përshtatur nga <https://partnersalbania.org/News/paketa-ligjore-mbi-ndermarrjet-sociale-ne-shqiperi/>)

### 3.3 MODELI I VLERËSIMIT TË CEC-së DHE REKOMANDIMET PËR SHQIPËRINË

Komunitetet e energjisë dhe (bashkë)pronësia e konsumatorit janë guri i themelit të suksesit të përgjithshëm të Tranzicionit të Energjisë. Kur konsumatorët fitojnë pronësinë në stacionet e CEC-së, ata mund të bëhen konsumatorë prodhues, duke prodhuar një pjesë të energjisë që ata konsumojnë. Kjo iu mundëson uljen e shpenzimeve të përgjithshme për energji dhe njëkohësisht të fitojnë një burim tjetër të të ardhurave nga shitja e prodhimit të tepërt. Konsumim-Prodhimi pritet të ngulitet gjithnjë e më shumë në komunitetet e energjisë që përfshijnë një larmi të gjerë aktorësh. Nga pikëpamja teknike, këto zhvendosje organizative në prodhimin, furnizimin dhe menaxhimin e energjisë ndodhin në kontekstin e kompleksitetit në rritje të sistemeve të energjisë; megjithatë, në këtë studim kërkimor ne jemi përqendruar në formën e organizimit të Komuniteteve të Energjisë për Qytetarët.

Komunitetet e energjisë dhe grupet e energjisë janë imazhe të ngjashme qeverisëse dhe teknologjike të të njëjtit koncept, duke përfshirë fleksibilitetin, drejtimin e dyfishtë dhe opsionet e ndërlidhjes midis konsumatorëve prodhues dhe prodhuesve të energjisë dhe tregut, duke lejuar ndarjen e energjisë të portofolit të BRE-ve, që mund të përmirësojë plotësueshmërinë



**Figura 6:** Elementë të grupeve të energjisë


Burimi: Komunitetet ER sipas Paketës Evropiane të Energjisë së Pastër 2019 – Modeli i Drejtitimit

### 3.3.1 MODELI TIPIK

Modeli tipik i komunitetit të energjisë inteligjente është rrjeti i komunitetit, ku një nga palët e interesit është operatori i rrjetit të komunitetit. Ky mund të jetë OSSH-ja aktuale (Operatori i Sistemit të Shpërndarjes) ose mund të jetë një model i ri në nivel komuniteti i menaxhuar privatisht ose brenda një grupi komuniteti. Ky model i ri për menaxhimin e rrjetit krijon një treg të ri. Biznesi që ka dalë si i ri ka nevojë për mbështetje nga palët e tjera të interesit, duke përfshirë politikë-bërësit vendorë dhe kombëtarë, ofruesit e teknologjisë, autoritetet vendore (këshillet e qytetit ose agjencitë e energjisë) dhe komuniteti në përgjithësi.

Pronari i shtëpisë përfiton nga ky model i ri duke blerë energji elektrike më të lirë nga një burim i besuar, operatori i rrjetit të komunitetit ofron shërbimet e menaxhimit të energjisë (si biznes) dhe vepron si ndërhyrës midis banorëve të komunitetit dhe OSSH-së në nivelin e rrjetit. Komuniteti pastaj mund të zhvillojë aktivitete të qëndrueshme duke përfshirë skema të planifikimit të menaxhimit të energjisë rezidenciale, edukim mbi teknologjitë më të fundit për banorët, seminare lokale me rregullatorë, aktivitete në shkolla për projekte të gjelbra dhe në përgjithësi duke rritur një grup të bazuar në komunitet të praktikave më të mira në të cilat të gjithë kanë të drejta dhe të gjithë përfitojnë.

Një sistem tipik i rrjetit të komunitetit tregohet në Figurën 7 më poshtë.



**Figura 7:** Koncepti i rrjetit të komunitetit  
 Burimi: Angazhimi i Qytetarëve si Model Biznesi për Komunitetet e Energjisë Inteligjente

Fokusi në këtë model është organizimi i grupeve të konsumatorëve prodhues, duke përfshirë komunitetet vendore, kompanitë e furnizimit me energji dhe kooperativat. Kjo i lejon konsumatorët të tregtojnë kontrata afatshkurtra të energjisë brenda OSSH-së. Autoritetet vendore duhet të bashkëpunojnë me grupet e qytetarëve në zhvillimin e këtij modeli biznesi me përqendrimin tek qytetarët, duke i organizuar konsumatorët që të marrin pjesë në këtë aktivitet dhe duke treguar se sa mund ta kontrollojnë konsumatorët biznesin e tyre të energjisë në mënyrë aktive.

### 3.3.2 CEC-ET POTENCIALE NË SHQIPËRI

Ky seksion ofron analizë dhe ndarje më të detajuar të grupit të palëve të interesit të komuniteteve, duke marrë parasysh nëngrupet, si dhe elementet specifike të përdorimit të energjisë nga secili nëngrup. Siç u përmend më parë, individët/komunitetet, banorët dhe pronarët e bizneseve të vogla, konsiderohen si Palët kryesore të interesit, duke qenë edhe shumica e konsumatorëve të mundshëm.

Për sa i përket shtrirjes gjeografike, këto grupe parashikohet të jenë të strukturuar dhe operacionale në një qytet/fshat ose lagje.

Për më tepër, për qëllimin e këtij studimi kërkimor, janë identifikuar tre nëngrupe si më poshtë:

#### **A. Godina dhe hapësira publike**

Këto përfshijnë (por nuk kufizohen): shkolla, qendra shëndetësore, shtëpi të moshuarish, biblioteka, godina të njëjësive bashkiake/administrative, parqe/sheshe, etj. Ato mund të përdorin hapësirat përkatëse, si çatitë, për të prodhuar ER, e cila nga ana tjetër mund të përdoret për vetë-konsum (ngrohje, ndriçim, etj.), por edhe si produkt që do të ndahet, duke u futur në rrjet.

#### **B. SME**

Këto përfshijnë kryesisht ndërmarrjet e orientuara drejt përpunimit të produkteve të komunitetit vendor. Në këto ndërmarrje futen fabrikat e shisheve, feramat e qumështit, objektet për ruajtjen e peshkut që operohen nga Organizata vendore e Menaxhimit të Peshkut, përpunimi i produkteve vendase (pemë dhe perime), të tilla si mollë, portokaj, rrush, karota, specat, etj. Si në nëngrupin e mëparshëm, ER-ja e prodhuar do të përdoret për vetë-konsum, ndërsa lidhja me

rrjetin e shpërndarjes, nëse do të jetë rasti, mund të kërkojë rregullime të veçanta ligjore.

Ky nëngrup përbën gjithashtu një shembull të mirë të bashkëpunimit të suksesshëm midis sipërmarrjeve private dhe komuniteteve vendore.

#### **C. Rezidenca të përbashkëta**

Këto përfshijnë ndërtesa me shumë apartamente në qytet ose disa shtëpi në një lagje në fshat. Hapësira që do të përdoret për instalimet e energjisë do të jetë hapësirë publike ose e pronës së përbashkët. Stacionet e prodhimit dhe përdorimit të energjisë që mund të përdoren në këtë rast përfshijnë:

- Stacione fotovoltaike të cilat mund të përdoren për: funksionimin e pompave të furnizimit me ujë, ashensorit, ndriçimit të shkallëve, etj.
- Stacionet e ngrohjes.
- Stacionet e ndriçimit publik.

Fondi i Komunitetit, i zbatuar nga Bashkia e Tiranës, mund të jetë pikënisje e mirë në këtë drejtim.

## 3.4 PERSPEKTIVA DHE PËRFUNDIMET PËR KOOPERATIVAT E ENERGJISË

### 3.4.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KOOPERATIVAT E ENERGJISË

Ndërsa kooperativat kanë ekzistuar për një kohë të gjatë (p.sh., në sektorin e bujqësisë) kooperativat e energjisë janë relativisht të reja. Edhe pse kooperativat e energjisë janë një nga format më të zakonshme të pronësisë lokale të energjisë dhe po fitojnë popullaritet, deri më tani nuk ka përkufizim të përbashkët ligjor për kooperativat e energjisë. Ka përshkrime të ndryshme si p.sh.:

↳ REScoop e përkufizon kooperativën ER si: *“model biznesi ku qytetarët zotërojnë së bashku dhe marrin pjesë në projekte për energji të qëndrueshme [përfshirë] si energjinë e rinovueshme (BRE) dhe eficientë e energjisë (EE).”*<sup>4</sup>

↳ Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social e përshkruan kooperativën e energjisë si: *“një shoqatë vullnetare me numër të pakufizuar anëtarësh dhe personash juridikë [me] qëllim [...]përmeshjen e nevojave energjetike të anëtarëve të saj.”*<sup>5</sup>

↳ Aleanca Ndërkombëtare e Kooperativave përcakton: *“Kooperativa është një shoqatë autonome e personave të bashkuar vullnetarisht për të përmeshur nevojat dhe aspiratat e tyre të përbashkëta ekonomike, sociale dhe kulturore përmes një ndërmarrjeje të përbashkët dhe të kontrolluar në mënyrë demokratike”. Kjo do të thotë që kooperativa është një formë biznesi në pronësi dhe e drejtuar nga dhe për anëtarët e saj. Vlerat thelbësore janë parimet e vetë-ndihmës, vetë-përgjegjësisë, demokracisë, barazisë, të drejtave që sjellin barazi, si dhe solidaritetit.”*<sup>6</sup>

Ashtu si kooperativat e tjera, kooperativat e energjisë duhet të ndjekin disa parime kyçe të kooperativave të rëna dakord ndërkombëtarisht:

- *Janë të hapura dhe vullnetare* - kooperativat janë organizata vullnetare të hapura për të gjithë personat e aftë dhe të gatshëm të përdorin shërbimet e tyre dhe të marrin përgjegjësitë e anëtarësimit.

- *Përfshijnë pronësi demokratike* - secili anëtar ka një votë dhe merr pjesë në përcaktimin e politikave dhe vendimeve të kooperativës, disa anëtarë zgjidhen përfaqësues.

- *Lejojnë pjesëmarrjen ekonomike* - qytetarët mund të blejnë aksione të kooperativës dhe të kenë akses në produktet ose shërbimet e saj; anëtarët kontribuojnë në mënyrë të barabartë dhe kontrollojnë në mënyrë demokratike kapitalin e kooperativës, ata zakonisht marrin kompensim të kufizuar dhe të gjitha tepricat zakonisht alokohen për të mbështetur aktivitetet e kooperativës.

- *Janë autonome dhe të pavarura* - kooperativat nuk kontrollohen nga ndërmarrjet private ose autoritetet publike; nëse ndërmerret ndonjë marrëveshje me organizata të tjera, ato duhet të garantojnë kontrollin demokratik të anëtarëve mbi kooperativën.

- *Ofrojnë informacion dhe trajnim* - kooperativat u ofrojnë anëtarëve, përfaqësuesve dhe punonjësve të tyre edukim dhe trajnim për t’u siguruar që anëtarët mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në zhvillimin e kooperativës, ndërkohë që ofrojnë informacion për publikun.

- *Bashkëpunojnë me kooperativa të tjera* në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

- *Kujdesen për komunitetin vendor* - kooperativat punojnë për zhvillimin e qëndrueshëm.


Kooperativa ka një strukturë të thjeshtë dhe funksionale organizative, e përbërë nga tre organe: **Asambleja e Përgjithshme**, **Bordi Ekzekutiv** dhe **Bordi Mbikëqyrës** (Figura 8). Bordi Ekzekutiv drejton kooperativën nën përgjegjësinë e tij, ndërsa Bordi Mbikëqyrës monitoron këto aktivitete. Asambleja e Përgjithshme është organi suprem ligjor i kooperativës, i cili zgjedh Bordin Mbikëqyrës, vendos për ndryshimet e statutit dhe çështje të tjera themelore. Statuti specifikon nëse Asambleja e Përgjithshme ose Bordi Mbikëqyrës është përgjegjës për zgjedhjen e Bordit Ekzekutiv. Çdo kooperativë ka një statut si një kushtetutë të brendshme, e cila plotëson dispozitat ligjore dhe përcakton strukturën, kompetencat dhe objektivat e kooperativës.

<sup>4</sup>Creupelandt D. dhe Vansintjan, D. REScoop - Mobilizimi i Qytetarëve Evropianë për të Investuar në Energji të Qëndrueshme, të Dorëzueshme 2.3 REScoop - Qasja e Bashkisë

<sup>5</sup>Komiteti Evropian Ekonomik dhe Social, 2016, Energjia e Prodhim-Konsumatorëve dhe Kooperativat e energjisë të Prodhim-Konsumatorëve: mundësitë dhe sfidat në vendet e BE, OpinionTEN / 583.

<sup>6</sup>Aleanca Ndërkombëtare e Kooperativave, 2017





**Figura 8:** Struktura organizative e kooperativës  
 Burimi: WECF, ZEZ. 2018. Kooperativa e Energjisë - Analizë Krahasuese në vendet e Partneritetit Lindor dhe Ballkanit Perëndimor

Si përfundim, kooperativat e energjisë kontribuojnë në arritjen e objektivave të klimës, energjisë dhe ato mjedisore. Nga njëra anë, ato mund të sjellin qëllimet e politikës kombëtare, rajonale si dhe të BE-së, më pranë qytetarëve duke përmirësuar pranimin lokal për projektet e tranzicionit të energjisë<sup>7</sup>. Nga ana tjetër, ato mund të kontribuojnë në përmbushjen e qëllimeve të politikës kombëtare të klimës duke kontribuar në stacionet e kapacitetit ER, kursimet e energjisë dhe përmirësimet e efikasitetit të energjisë. Për shembull, kooperativat energjetike mbështesin autoritetet vendore për të përmbushur objektivat e tyre të klimës dhe energjisë.

### 3.4.2 NDIKIMI SOCIO-EKONOMIK I KOOPERATIVAVE TË ENERGJISË

Kooperativat energjetike kanë disa ndikime kryesore socio-ekonomike, disa prej të cilave ndahen gjithashtu me llojet e tjera të modeleve vendore të pronësisë së energjisë. Një nga ndikimet më të rëndësishme të kooperativave të energjisë

është kontributi i tyre në demokracinë e energjisë dhe “grupet e qytetarëve për energjinë”. Ndërsa koncepti i parë i referohet kryesisht vendimmarrjes së përbashkët në lidhje me politikat e energjisë (dhe klimës), i fundit i referohet më gjerësisht “rritjes së ndërgjegjësimit midis qytetarëve dhe komuniteteve për çështjet e energjisë” e cila nga ana e saj mundëson kontribut më të gjerë në tranzicionin e energjisë. Kjo do të thotë jo vetëm që qytetarët dhe komunitetet e energjisë do të bëhen konsumatorë aktivë ose konsumatorë prodhues, por gjithashtu që ata gradualisht do të fillojnë të marrin pjesë në funksionimin e rrjeteve të shpërndarjes, furnizimit me energji dhe kompanive të shërbimit të energjisë për shembull përmes kooperativave të energjisë. Ky demokratizim i sistemit të energjisë mund të sigurojë pranim dhe ndërmarrje më gjerësisht të projekteve të ER dhe të çojë në ulje të çmimeve të energjisë, veçanërisht për konsumatorët e varfër të energjisë.

Kooperativat e energjisë janë model i përshtatshëm për të planifikuar, financuar dhe zbatuar projekte të energjisë së rinovueshme dhe ofrojnë shumë përparësi:


1. Ekuilibri i interesave: Mundësimi i aktorëve të ndryshëm për t’u përfshirë në procesin e vendimmarrjes në nivel vendor dhe për të kombinuar interesat ekonomike, sociale dhe komunale;
2. Pranimi: Rritja e pranimin të qytetarëve për zbatimin e projekteve të energjisë së rinovueshme përmes pjesëmarrjes aktive;
3. Vlera e shtuar rajonale: Forcimi i ekonomisë vendore përmes investimeve të përbashkëta të qytetarëve në projekte që realizohen me kompani vendase dhe banka, punëtorë dhe projektues. Për më tepër, bashkitë përfitojnë nga të ardhurat nga taksat dhe shkalla e papunësisë ulët;
4. Drejtësia sociale: Reduktimi i padrejtësisë sociale, sepse edhe gratë dhe qytetarët me të ardhura të ulëta mund të marrin pjesë aktivisht në tranzicionin e energjisë si anëtarë të kooperativës.
5. Industria e energjisë e bazuar në nevoja: Mundësimi i furnizimit me energji për t’iu përshtatur nevojave specifike, e cila bazohet në mbështetjen e anëtarëve në vend të fitimit të lartë për aksionerët;

<sup>7</sup> Fuqia e Komunitetit, Miqtë e Tokës dhe REScoop, Përfitimet e Komunitetit të Pronësisë

6. Angazhimi afatgjatë: Kooperativat e energjisë nuk janë pjesëmarrje e qytetarëve e bazuar krejtësisht në kapital, por ndërmarrjet rajonale që kanë potencialin për të formuar furnizimin rajonal të energjisë në një periudhë afatgjatë dhe janë pjesë e një politike gjithëpërfshirëse për “zhvillimin e komunitetit”. (DGRV Bundesgeschäftsstelle Energiegenossenschaften 2007).

Kooperativat e energjisë gjithashtu mund të kontribuojnë në ekonominë lokale. Ato mund të krijojnë drejtpërdrejt vende pune në tregun vendor, p.sh., për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e stacioneve të ER-së, dhe të kontribuojnë në uljen e daljes së kapitalit që vjen nga importet e karburantit, të cilat mund të prodhojnë indirekt vende pune në sektorë të tjerë. Kooperativat e energjisë dhe projektet e komunitetit gjithashtu kanë më shumë gjasa të kontraktojnë kompani vendore ose të përdorin banka vendore dhe të investojnë sërish fitimet e tyre në komunitet<sup>8</sup>. Kooperativat e energjisë synojnë të maksimizojnë vlerën vendase dhe kështu të kontribuojnë në mirëqenien sociale dhe ekonomike të komuniteteve vendore. Ato mund të promovojnë një ekonomi ‘qarkore’ në nivel vendor, ku fitimet e ER-së investohen për të promovuar objektiva të tjerë të energjisë siç janë rinovimet e ndërtesave dhe kursimet e energjisë<sup>9</sup>.

Formimi i kooperativave të energjisë lejon demonopolizim dhe demokratizim të njohurive të ekspertëve dhe hyrjen e aktorëve të rinj - gra, burra, të rinj, etj. - në sektorin e energjisë dhe demonstroi një alternativë ndaj industrisë ekzistuese të energjisë fosile dhe drurit. Të kthyerit në “konsumatorë prodhues” të energjisë - që do të thotë njëkohësisht prodhues dhe konsumatorë - në kontekstin vendor është procesi politik i të mësuarit dhe zhvillimit me përfaqësim sa më të gjerë dhe të larmishëm nga të gjitha pjesët e shoqërisë. Përvoja e grave që janë përgjegjëse për ngrohjen dhe gatimin në familje merret qartë në konsideratë dhe ndihmon në përshtatjen e duhur të zgjidhjeve të energjisë së rinovueshme. Njohuritë dhe përvoja e shtuar në lidhje me energjinë e rinovueshme rrit pranimin gjerësisht në publik, çka është e rëndësishme që procesi transformues të shkojë drejt një ekonomie dhe shoqërie të dekarbonizuar.



**Figura 9:** Modeli i biznesit i energjisë së Kooperativës

Burimi: Bryant, Straker, dhe Wrigley, 2018

<sup>8</sup> Fuqia e Komunitetit, Miqtë e Tokës dhe REScoop, Përfitimet e Komunitetit të Pronësisë.

<sup>9</sup> Creupelandt D. dhe Vansintjan, D. REScoop - Mobilizimi i Qytetarëve Evropianë për të Investuar në Energji të Qëndrueshme, të Dorëzueshme 2.3 REScoop - Qasja e Bashkisë

### 3.4.3 MJETI PËR FUQIZIMIN E GRAVE DHE DREJTËSINË GJINORE


Kanë kaluar njëzet vjet që kur Konferenca Botërore e Pekinit për Gratë në 1995 e vuri fokusin në mbylljen e hendekut gjinor, por pabarazitë gjinore të rrënjosura thellë kanë vazhduar përtej synimit të vitit 2015. Gratë nuk janë ende të përfaqësuara njëjloj si vendimmarrëse politike dhe ekonomike; vuajnë mungesën e aksesit në punë të mira, me rroga të drejta, si dhe punësimit të sigurt; dhe ka më shumë të ngjarë të punojnë në punë informale dhe të papaguara. Duke pasur parasysh këtë realitet, Kombet e Bashkuara kanë rënë dakord të japin përparësi për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave duke krijuar një Qëllim më vete të Zhvillimit të Qëndrueshëm - QZHQ 5 - për të rritur barazinë gjinore. Për shkak të vlerave të tyre themelore, kooperativat janë formë e përshtatshme ligjore për të trajtuar shumë nga çështjet që ndikojnë negativisht tek gratë.

Kooperativat ofrojnë alternativë ndaj modelit të aksionerëve mbi pronësinë e biznesit. Në përgjithësi:

- kanë ndikim gjithnjë e më pozitiv mbi gratë dhe përfshirjen e tyre në fuqinë punëtore dhe ekonominë formale.
- mund të fuqizojnë gratë duke bashkëpunuar me SHC dhe duke fituar njohjen nga qeveria.
- mund të vazhdojnë të zhvillojnë politika që mbështesin gratë nga brenda.
- Proceset demokratike kërkojnë vendimmarrje të përbashkët midis grave dhe burrave.
- Kontribut për barazinë gjinore duke zgjeruar mundësitë e grave për të marrë pjesë në ekonominë lokale.
- Lidhje të forta midis përfshirjes bashkëpunuese të grave dhe uljes së varfërisë.

Kooperativat energjetike me të drejta gjinore mund të:

- sigurojnë akses të barabartë për gratë në të gjithë zinxhirin e vlerës së energjisë: teknologjitë, vendet e punës, fondet, dividendët.
- ulin ngarkesën e punës: kursejnë koston dhe kohën.
- Sigurojnë kontroll mbi prodhimin dhe konsumin e energjisë.
- nxisin fuqizimin dhe drejtimin e grave.
- angazhohen për politikat gjinore dhe energjetike të kooperativave.



**Figura 10:** Zbatimi i strategjive gjinore rrit barazinë për gratë e burrat

Burimi: WECF

### 3.4.4 PRONËSIA E ENERGJISË VENDORE/ MODELET E KOOPERATIVAVE NË BE

Në disa vende të BE-së, ka një rritje të ER-së, që tani prodhohet nga kooperativat. Për shembull, në Gjermani, ka më shumë se 600 kooperativa të ER-së dhe grupe vendase, ku përfshihen disa projekte në pronësi të komunitetit që prodhojnë energji elektrike. Kooperativat ER gjithashtu ofrojnë mundësi të re për prodhimin dhe pronësinë lokale të energjisë, duke transformuar tregun e energjisë dhe duke përcaktuar skemat kombëtare.

Më poshtë jepen shembuj të modele ekzistuese të pronësisë të sektorit energjetik në katër vende të BE-së: Danimarkë, Gjermani, Irlandë dhe Greqi.

#### 3.4.4.1 PËRVOJA E DANIMARKËS

Danimarka ka histori të mbështetjes së zhvillimit të BRE-ve dhe konsiderohet si vendi pionier në lidhje me energjinë e erës që nga vitet 1970. Masat e marra në vitet 1970 dhe 1980 përfshijnë përjashtime nga taksat për të ardhurat nga turbinat e erës, tarifat fikse FiT, lidhje të garantuar të rrjetit, blerje të obligacioneve dhe përparësi transmetimi të energjisë nga era.

Danimarka gjithashtu ka traditën e pronësisë së kooperativave, veçanërisht në sektorin e bujqësisë, dhe aktivizmin e energjisë vendase (p.sh., kundër prodhimit të energjisë bërthamore). Prandaj, nuk është për t'u habitur që Danimarka ka promovuar pronësinë vendore të BRE-ve nga qytetarët, ndërmarrjet dhe kooperativat, veçanërisht ato të energjisë së erës, përmes masave të synuara, si p.sh. skemave të planifikimit dhe rregullimeve specifike. Edhe pse ligji danez i ndalon kooperativat të kenë në pronësi turbina ere, ka pasur forma të tjera të pronësisë për të lehtësuar pjesëmarrjen e qytetarëve vendas. Komunitetet kanë prirjen të marrin pronësinë e përbashkët përmes një partneriteti ligjor, i cili në mënyrë thelbësore funksionon në të njëjtën mënyrë si një kooperativë.

Në këto partneritete, individët kombinojnë fondet e tyre për të blerë turbina, ku projektet e komunitetit janë të financuara plotësisht përmes shitjes së aksioneve. Rrjedhimisht, anëtarët e partneritetit janë të mbrojtur ndaj përgjegjësisë së borxheve përtej burimeve të partneritetit, tek të cilat secili anëtar përgjigjet vetëm për shumën e investuar. Kjo ka ndihmuar në kapërcimin e rreziqeve të përgjegjësisë së përbashkët dhe ka inkurajuar më shumë investime të qytetarëve në prodhimin vendor të energjisë.

#### 3.4.4.2 PËRVOJA E GJERMANISË

Në Gjermani ekziston një mbështetje e fortë dhe e qëndrueshme për energjinë e rinovueshme, megjithëse është e kohëve më e fundit, me një "Energiewende" zyrtare, ose "tranzicion të energjisë" të prezantuar në 2010. Politika kombëtare synon të promovojë si energjinë e erës ashtu edhe atë diellore. Tranzicioni përfshin synime dhe masa ambicioze (p.sh. tarifat FiT) që synojnë promovimin e energjisë së rinovueshme, eficientë e energjisë dhe reduktimin e gazit serë. Kjo plotësohet me politika të forta dhe mbështetje të gjerë publike për pronësinë e komunitetit në prodhimin e ER-së. Edhe pse nuk ka mbështetje të qartë të politikave për energjinë e komunitetit, përveç mbështetjes politike rajonale në gjetjen dhe sigurimin e hapësirave për stacionet e BRE-ve (p.sh., çatitë për stacionet e energjisë diellore), që nga viti 2012 afërsisht gjysma e kapacitetit të ER-së është e instaluar sipas një forme të pronësisë së komunitetit.

Autoritetet vendore në Gjermani përfitojnë nga një shkallë e caktuar e autonomisë dhe përgjegjësisë për veprimet vendore. Autonomia bashkiake dhe "*e drejta për të rregulluar të gjitha çështjet vendore me përgjegjësinë e tyre*", është e vendosur në ligjin gjerman. Si rezultat, bashkitë kanë kompetenca të konsiderueshme ekzekutive (për shembull, janë përgjegjëse për zbatimin e një pjese të madhe të legjislacionit kombëtar dhe të BE-së). Këto kompetenca kufizohen nga parimi i lokalizimit dhe klauzola e varësisë, e cila kufizon çdo veprimtari të autoritetit vendor në zonën gjeografike nën administrimin e tij dhe lejon që autoritetet vendore të drejtojnë një shërbim publik vetëm nëse mund ta bëjnë në mënyrë efikase si palë e tretë.

Suksesi i energjisë së komunitetit në Gjermani mund t'i atribuohet një sërë faktorësh që përfshijnë: lëvizjen e fortë mjedisore dhe të energjisë alternative dhe një traditë të përgjithshme të formimit të kooperativave dhe të shoqatave të tjera për të arritur ndryshim në nivel vendor; një nivel të lartë të drejtimit dhe mbështetjes nga bashkitë; si dhe faktorë të tjerë institucionalë në makro-niveleve, siç është sistemi i tarifave FiT dhe bankat zhvillimore në pronësi të shtetit, KfW.

Për më tepër, Gjermania eksploron koncepte novatore siç janë centralet virtuale që mund të lehtësojnë aksesin e prodhuesve të decentralizuar të bazuar në komunitet.

#### 3.4.4.3 PËRVOJA E IRLANDËS

Irlanda është një nga vendet me përdorim më intensiv të energjisë për frymë në Evropë duke krijuar rreziqe ekonomike

dhe gjeopolitike për vendin. Për të trajtuar rreziqet, vendi ka hartuar një sërë politikash dhe masash për të promovuar energjinë e rinovueshme dhe eficientën e energjisë me fokus, edhe pse të vogël, në komunitetet e energjisë.

Aktualisht, energjia e rinovueshme në pronësi të komunitetit në Irlandë është një industri e vogël, por në rritje të shpejtë. Kjo ka ardhur si rezultat i pengesave domethënëse që nuk lejojnë suksesin e këtyre grupeve dhe projekteve dhe si rezultat, energjia e komunitetit në Irlandë përfaqëson sasi shumë të vogël të prodhimit dhe potencialit të përgjithshëm të energjisë. Për shembull, vendi aktualisht nuk ka strategji kombëtare për energjinë e komunitetit. Politika kombëtare e energjisë nuk e merr në konsideratë në mënyrë adekuate potencialin e energjisë së komunitetit dhe nuk ofron drejtim të qartë për të mbështetur projekte, grupe, partneritete të energjisë të komunitetit. Për më tepër, asnjë rregull nuk lehtëson krijimin e kooperativave energjetike për të garantuar entitet juridik për komunitetet e energjisë.

Për më tepër, "Kooperativat e Energjisë, Irlandë" po punon mbi lëvizjen e kooperativave të BE-së dhe mbështet kooperativat e ER-së në çdo fazë të zhvillimit të tyre, duke i drejtuar përmes proceseve ligjore, duke i këshilluar për bashkëveprimin me agjencitë shtetërore, duke i prezantuar me kooperativa të tjera dhe duke i ndihmuar të komunikojnë mesazhin e tyre në nivel vendor dhe kombëtar.

Ka disa pengesa që i privojnë komunitetet të zhvillojnë projektet e tyre, duke përfshirë aksesin në financim dhe këshilla në fazat fillestare të zhvillimit të projektit dhe aksesin në rrjetin e energjisë. Aktualisht lidhja me Rrjetin Kombëtar të Energjisë Elektrike për një komunitet vendor të energjisë është mjaft e gjatë dhe me shumë kosto.

### 3.4.4.4 PËRVOJA E GREQISË

Struktura e regjimit të mbështetjes për energjinë elektrike të rinovueshme në Greqi po ndryshon. Në Janar 2018, u votua një ligj i ri për komunitetet e energjisë në Parlamentin e Greqisë, i cili përcakton rolin e qytetarëve në sektorët e energjisë dhe i jep hapësirë të gjerë komuniteteve të energjisë. Ligji nxit qytetarët, autoritetet vendore dhe agjencitë private dhe publike të marrin pjesë në prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji; në thelb, ai u ofron konsumatorëve të energjisë elektrike mundësinë për t'u shndërruar në prodhues të energjisë elektrike. Nxitësi kryesor për reformën është që Greqia të arrijë përputhjen me Udhëzimet e Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore për

mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë për periudhën 2014-2020 (Udhëzimet).

Ligji u mundëson komuniteteve vendore të energjisë që të vendosin strukturat e pronësisë dhe ndalon vendosjen e tarifave për komunitetet e energjisë së rinovueshme që nuk paguajnë me kosto reale.

Ka raporte që sugjerojnë se disa bashki tashmë janë duke ndërmarrë hapa për krijimin e komuniteteve vendore të energjisë. Është raportuar se Larisa, Selaniku dhe disa bashki në Athinë tashmë po përgatisin matje virtuale të rrjetit dhe po hartojnë plane që do të siguronin energji diellore falas për familjet që vuajnë nga varfëria energjetike. Dispozitat e reja për investime virtuale të ndarjes së energjisë mund të jenë veçanërisht të rëndësishme, pasi ato mund të lejojnë që konsumi të ndodhë në një vend tjetër nga vendi ku prodhohet energjia. Kjo është kritike në pjesë të Greqisë ku banorët jetojnë në ndërtesa me shumë apartamente dhe nuk kanë hapësirë për stacione mikro-prodhuese.

### 3.4.5 PËRMBLEDHJE E PËRVOJAVE SI MËSIMETË NXJERRA

Duke marrë parasysh pengesat me të cilat mund të përballen komunitetet/kooperativat vendore të energjisë dhe kushtet e nevojshme për suksesin e tyre, politikëbërësit në nivele të ndryshme të qeverisjes duhet të ofrojnë kornizë të qëndrueshme ligjore dhe rregullatore në këtë drejtim dhe të ndërmarrin veprime më konkrete për të promovuar zhvillimin e komuniteteve vendore të energjisë. Veprimet specifike përshkruhen më poshtë.

**Politikëbërësit kombëtarë** janë përgjegjës jo vetëm për transpozimin dhe zbatimin e legjislacionit të BE-së por edhe për përcaktimin e objektivave dhe stimujve specifike kombëtarë për komunitetet vendore të energjisë. Prandaj, ata duhet:

- **Të njohin rolin dhe nevojat specifike të komuniteteve vendore të energjisë në politikën dhe legjislacionin përkatës kombëtar:** Vendet duhet të ndjekin hapat e ndërmarrë në nivelin e BE-së për përcaktimin e roleve të komuniteteve vendore të energjisë dhe të miratojnë përkufizime dhe dispozita të ngjashme për aktivitetet e tyre. Politikëbërësit kombëtarë gjithashtu mund të përcaktojnë objektiva konkretë për energjinë e komunitetit dhe kontributin e saj në qëllimet kombëtare të energjisë. Sidoqoftë, politikëbërësit kombëtarë duhet të tregojnë kujdes që të mos propozojnë përkufizime

ose objektiva të cilat janë shumë kufizuese dhe mund të përjashtojnë disa lloje të prodhuesve dhe konsumatorëve individualë dhe komunitetet vendore të energjisë.

- **Të vendosin politikat dhe rregullat që promovojnë komunitetet vendore të energjisë dhe bashkëpunimin vendor:** Për të plotësuar objektivat e mundshëm për energjinë e komunitetit, politikëbërësit kombëtarë gjithashtu mund të vendosin politika/rregulla specifike për promovimin e komuniteteve vendore të energjisë. Këto rregulla mund të marrin forma të ndryshme dhe të synojnë aspekte të ndryshme të modeleve vendore të pronësisë së energjisë, siç janë përqendrimi i tyre në përfitimet vendore, qëndrueshmërinë ose përfitimet mjedisore.

- **Të miratojnë procedura të thjeshta dhe proporcionale rregullatore dhe administrative për komunitetet vendore të energjisë:** Politikëbërësit duhet të ofrojnë procedura të thjeshta dhe proporcionale administrative për projekte të vogla të ER-së (p.sh., të drejtuara nga individë të veçantë) dhe komunitetet vendore të energjisë për t'u siguruar që procedurat e vështira të mos i pengojnë aktivitetet e tyre. Dispozitat që inkurajojnë Shtetet Anëtare të ngrenë 'one-stop shop' dhe të vendosin afate kohore për procedurat e lejimit për projektet e BRE-ve të propozuara në DER-in e ri, janë bazë e rëndësishme mbi të cilën Shteti Anëtar mund të ndërtojë zgjidhje të përshtatura për kontekstin e tyre kombëtar.

- **Të sigurohen që komunitetet vendore të energjisë të kenë akses në informacionet teknike, udhëzimet dhe financa:** Politikëbërësit kombëtarë mund të krijojnë skema mbështetëse financiare të dedikuara për komunitetet vendore të energjisë, për t'i ndihmuar veçanërisht gjatë fazave të planifikimit dhe ngritjes së projekteve. Këto mekanizma mund të jenë, për shembull, dhënia e granteve për kredi, garancitë ose mundësi të kredive të lira. Për më tepër, politikëbërësit kombëtarë duhet të lehtësojnë aksesin e komuniteteve vendore të energjisë në informacionet teknike dhe udhëzimet në lidhje me ngritjen, financimin dhe funksionimin e projekteve të komunitetit.

**Autoritetet vendore** mund të plotësojnë politikat kombëtare dhe të BE-së për promovimin e komuniteteve vendore të energjisë dhe të jenë partnerë të rëndësishëm për komunitetet vendore të energjisë. Prandaj, Autoritetet Rrajonale Vendore (ARRV-të) duhet:

- **Të miratojnë politika vendore për zhvillimin e komuniteteve vendore të energjisë:** ARRV-të mund të plotësojnë politikat

e BE-së dhe ato kombëtare duke miratuar objektiva të mëtejshëm vendorë për kontributin e komuniteteve vendore të energjisë në synimet vendore të energjisë. Prandaj, ARRV-të duhet të identifikojnë se si komunitetet vendore të energjisë mund të kontribuojnë më mirë në përmbushjen e qëllimeve vendore të energjisë (dhe objektiva të tjerë, siç janë qëllimet e politikës sociale) dhe të krijojnë mekanizma që mbështesin zhvillimin e tyre, përfshirë shërbimet këshilluese ose sigurimin e mbështetjes financiare.

- **Të eksplorojnë mundësitë për të vendosur partneritet ose për të krijuar komunitete vendore të energjisë:** Për të forcuar kontributin e komuniteteve vendore të energjisë në qëllimet e politikës vendore, ARRV-të gjithashtu mund të bëjnë partneritet me komunitetet ekzistuese ose të krijojnë partneritete të reja në bashkëpunim me qytetarët vendorë. ARRV-të dhe komunitetet vendore të energjisë janë partnerë të përshtatshëm, pasi ARRV-të mund të krijojnë hapësira për projekte të ER-së, mbështetje administrative dhe akses në kapital me norma preferenciale, ndërsa komunitetet vendore të energjisë mund të ofrojnë ekspertizë teknike dhe të mbikëqyrin funksionimin e projekteve.

### 3.4.6 HAPAT PËRMBLEDHËS PËR CEC-ET SHQIPTARE

Në fund të këtij dokumenti paraqitet një afat kohor, i cili mund të përdoret për hartimin e planeve të veprimit në bashkëpunim me të gjitha palët e interesit të identifikuar në lidhje me zhvillimin e CEC-ve në Shqipëri.

1. Në kuadër të procesit të filluar nga Milieukontakt, për të promovuar CEC përmes takimeve të parashikuara dhe atyre që pasojnë këtë projekt, për të punuar për krijimin e **Forumit të OJQ-ve CEC në Shqipëri**, i cili do të jetë baza e grupit të punës për të hartuar platformën e politikat alternative të shoqërisë civile.

2. Forumi OJQ\_CECsë pari do të duhet të hartojë një **Dokument të Politikave** si dokument zyrtar për pozicionimin e platformës së themelimit të CEC-së, i cili do të bëjë të mundur dorëzimin tek vendimmarrësit të kërkesave për ndryshimet ligjore dhe planet e veprimit, si dhe planet e biznesit të modelit të CEC-ve. Për të pasur një mbulim sa më të gjerë të mundshëm të aktorëve që veprojnë në Shqipëri, Forumi duhet të hartojë një **Listë të Kontakteve** të personave, grupeve dhe institucioneve kryesore, si dhe të të gjitha OJQ-ve dhe Bizneseve që lidhen me sektorin e energjisë alternative.

3. Pjesë të Dokumentit të Politikave duhet të paraqiten, ndër të tjera, këto drejtime të punës për të ardhmen, duke marrë parasysh përvojën e disa viteve më parë me “Agjendën e Gjelbër”:

- a. Përfshirja e CEC si term praktike në hapësirat ligjore dhe rregullatore të sektorit të energjisë**
- b. Krijimi i planeve të biznesit dhe fondeve për fillestarët e CEC-ve.**
- c. Hartimi i një Platforme të Ndërgjegjësimit dhe Ndërveprimit me Median**
- d. Pjesëmarrja në Akademinë e CEC-ve**

4. Paralelisht me hapat e mësipërm, duhet të vendosen mekanizmat e mbështetjes ekonomike dhe financiare në lidhje me shpërndarjen e teknologjisë dhe mbështetjen teknike dhe financiare të iniciativave të CEC-ve. Për këtë, hapi i parë nga projekti aktual është realizimi i **Shkollave Verore**, të cilat bëhen në kuadër të **Akademisë CEC**. Transferimi i njohurive rreth CEC-ve duhet të përfshihet në **Kurrikulën e Shkollave Teknike të Sistemit Arsimor Shqiptar**. Përmes këtij procesi, do të krijohet tregu i nevojshëm i profesionistëve dhe promovuesve për t’i bërë CEC të stabilizuara si struktura të pavarura sociale, teknike dhe ekonomike.

5. Sigurisht që koha e zhvillimit të hapave të mësipërm dhe kompleksiteti i qëndrueshmërisë së CEC-ve nuk është diçka që mund të arrihet në një kohë të shkurtër dhe për këtë arsye **modelet e vendosura** deri më tani në vende të ndryshme të BE-së janë shembulli më i mirë për të shpejtuar kohën, por pa harruar që konteksti shqiptar ka shumë **paqartësi dhe pengesa** nga e kaluara dhe veçanërisht në lidhje me konsolidimin institucional të CEC-ve (çështjet e ngritura në këtë dokument dhe të cilat do të duhet të shtjellohen më tej në praktikë).

6. Në planin e veprimit që do të hartohet dhe në modelet e ndryshme të planit të biznesit, **konteksti i CEC-ve në zonat urbane dhe rurale** duhet të prezantojë mundësi të cilat ndihmojnë në zbatimin e parimeve të CEC-ve dhe atyre praktikave të cilat nuk bëhen më të ndërlikuara me pengesa (modelet thelbësore të vogla) siç janë ato të modeleve të menaxhimit të pallateve në zonat urbane dhe ato të përfshira në skemat agro-ushqimore në zonat rurale dhe në përgjithësi skemat sociale të financuara nga komuniteti që plotësojnë nevojat e vetë komunitetit dhe hapësirave publike.

7. **Ekspertiza e nevojshme e kontraktuar** duhet të gjendet sa më afër komunitetit dhe siç u përmend më lart për këtë

trajnim, duhet të bëhen module dhe botime të veçanta përveç punës që do të bëhet nga Akademia e CEC-ve.

Si përfundim, duhet thënë se procesi i konsolidimit të CEC-ve është i gjatë, por fillimi i mirë është baza e duhur për ta arritur këtë qëllim.

---

## 4. REFERENCAT

Shqipëri, VKM Nr. 342, datë 22.05.2019 për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve për audituesit e energjisë.

Shqipëri, VKM Nr. 407, datë 19.06.2019 për miratimin e procedurave, kategorive, kushteve dhe kërkesave të kualifikimeve dhe përvojës profesionale për energji, e cila përcakton procedurat, kategoritë dhe kërkesat për lëshimin e certifikatave të auditimit të energjisë

Shqipëri, VKM Nr. 430, datë 11.07.2018 për krijimin e bazës së të dhënave qeveritare për sistemin e lejeve elektronike (e-leje)

Shqipëri, Udhëzimi i MIE nr. 3, datë 20.6.2019 për Miratimin e Procedurës së lehtësuar të Autorizimit për Lidhjen në Sistemin e Shpërndarjes të Projekteve të Vogla të Rinovueshme për Vetëprodhuesit e Energjisë elektrike nga dielli

Shqipëri, Ligji Nr. 124/2015 “Për Eficiencën e Energjisë”

Shqipëri, Ligji nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë së Ndërtesave”.

Shqipëri, Ligji nr.7 / 2017 “Për Burimet e Rinovueshme të Energjisë”.

Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (2020). Energjia e rinovueshme

Shqipëri, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore Raportet e Progresit të Energjisë së Rinovueshme 2014-2015

Shqipëri, Strategjia Kombëtare e Energjisë (SKE) e miratuar me VKM nr. 480, datë 31.07.2018

Bolle A., Qytetet e Energjisë (2019). Si mund t'i mbështesin qytetet komunitetet e energjisë së rinovueshme: Udhëzime për Politikëbërësit Vendorë dhe Rajonale

Caramizaru, A. dhe Uihlein, A., Komunitetet e Energjisë: një pasqyrë e energjisë dhe inovacionit shoqëror, 30083 EUR EN, Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, Luksemburg, 2020, ISBN 978-92-76-10713-2, doi: 10.2760 / 180576, JRC119433

Angazhimi i Qytetarëve si Model Biznesi për Komunitetet e Energjisë Inteligjente DOI: 10.1109 / EFEA.2018.8617063

Shkenca e Qytetarëve dhe Komunitetet e Energjisë për Qytetarët: Një Rishikim Sistemik dhe Aleanca të Mundshme për QZHQ-të. Qëndrueshmëria 2020, 12, 10096; doi: 10.3390 / su122310096

Aksioni i përbashkët dhe Inovacioni Social në Sektorin e Energjisë: Një perspektivë e modelit të mobilizimit. Energjitë 2020, 13, 651; doi: 10.3390 / en13030651

Projekti PIRBIR (2019) Përkufizimet e Komunitetit të Energjisë

ELECTRA ENERGY (2020). Hartëzimi i Komuniteteve të Energjisë në Greqi

Komuniteti i Energjisë (2020). Procesverbali i Mbledhjes së Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Shqipëri (2020). Raporti Vjetor i Zbatimit

Gjurmuesi i Tranzicionit të Energjisë WB6 i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (2020)

Eurelectric (2019) Komunitetet e Energjisë së Qytetarëve: Rekomandime për një kontribut të suksesshëm në dekarbonizimin

Miq të Tokës Evropë, REScoop.eu, Qytetet e Energjisë (2020). Energjia e Komunitetit - Një Udhëzues Praktik për Rimarrjen e Energjisë

Gallop P, Vejnović I, Pehchevski D, (2019). Hidrocentrali i Ballkanit Perëndimor: Kush paguan, kush fiton? - Si e kanë ushqyer bumin e vogël të hidrocentralit stimuluesit e energjisë së rinovueshme dhe çfarë duhet të ndryshojë

Haf, S. dhe Robison, R., 2020. Si mund të inkurajojnë autoritetet vendore pjesëmarrjen e qytetarëve në tranzicionet e energjisë. Londër: Qendra e Kërkimit të Energjisë në MB.

<http://www.akbn.gov.al/category/energji-e-rinovueshem-projektet-en/?lang=en>

<https://energy-community.org/implementation/Albania/CLIM.html>

<https://greeningthegrid.org/Renewable-Energy-Zones-Toolkit/topics/stakeholder-involvement>



---

<https://portavendore.al/wp-content/uploads/2019/06/Analiz%C3%AB-e-Kuadrit-Ligjor-mbi-Nd%C3%ABrmarjet-Sociale-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-1.pdf>

<https://smartcities-infosystem.eu/citizen-engagement>

<https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/projects/development-of-albania-fourth-national-communication-to-the-unfc.html>

[https://www.tirana.al/uploads/2019/5/20190516150040\\_vendim-nr-14-per-miratimin-e-programit-fondi-i-komunitetet.pdf](https://www.tirana.al/uploads/2019/5/20190516150040_vendim-nr-14-per-miratimin-e-programit-fondi-i-komunitetet.pdf)

Kontributi i Përcaktuar Kombëtar i Vendosur (INDC) i Republikës së Shqipërisë pas vendimit 1 / CP.19 dhe vendimit 1 / CP.20 të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës (UNFCCC)

Rajoni i Detit Baltik Interreg (2018) Harta dhe analiza e grupeve të interesit të RENCOP-ve rajonale

Projekti Interreg Evropa Qendrore, ENES-CE (2019). Kornizë e Përbashkët Metodologjike për Zhvillimin e Procesit të Planifikimit të Energjisë nga poshtë lart në CE

Projekti Interreg Europe, PASSAGE (2018). Plani i veprimit - Ngushtica e Otrantos dhe Korfuzit

Lowitzsch J, (2019) Investimi në të Ardhmen e Rinovueshme - Komunitetet e Energjisë së Rinovueshme, Bashkëpronësia e Konsumatorit dhe Ndarja e Energjisë në Paketën e Energjisë së Pastër

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shqipëri (2019). Forumi Ndërkombëtar i Kartës së Energjisë në Tiranë: Diversifikimi i Energjisë, të Rinovueshme dhe Eficienca e Energjisë. Përfundimet e Forumit

Modele të Pronësisë Vendore të Energjisë dhe Roli i Komuniteteve Vendore të Energjisë në Tranzicionin e Energjisë në Evropë (2018). Numri i katalogut: QG-01-18-933-EN-N; ISBN: 978-92-895-0989-3; doi: 10.2863 / 603673

Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri - 2015-2020

Dokumenti i Qëndrimit "Energjia dhe Planifikimi i Klimës Shqipëri 2030" (2020)

Proka, Antonia, Matthijs Hisschemöller dhe DerkLoorbach. "Kur "nga lart-poshtë" takohet me "nga poshtë-lart": A ka ndonjë model bashkëpunimi biznesi për ruajtjen e energjisë vendore?" *Energy Research & Social Science* 69 (2020)

Sfidat rregullatore dhe mundësitë për konsumatorët prodhues të përbashkët të energjisë së rinovueshme në BE. <https://doi.org/10.1016/j.enpol.2019.111212>

Komunitetet e energjisë së rinovueshme nën Paketën Evropiane të Energjisë së Pastër 2019 - Modeli i Qeverisjes për grupet e energjisë në të ardhmen (2020). <https://doi.org/10.1016/j.rser.2019.109489>

REScoop.EU, LICHT - një metodologji për mobilizimin e komuniteteve të energjisë

Roberts, J, Bodman, F dhe Rybski, R (2014). Fuqia e Komunitetit: Kornizat ligjore Model për Energjinë e Rinovueshme në pronësi të Qytetarëve. (ClientEarth: Londër).

Shkallëzimi i Investimeve Publike të Eficiencës së Energjisë përmes Standardizimit të Skemave të Financimit të Qytetarëve (CitizEE) Projekti (2020). Analiza e Kornizës Ligjore dhe Rregullatore

Hartëzimi dhe Analizimi i Palëve të Interesit të Industrisë së Energjisë së Rinovueshme në Indonezi. *Energjitë* 2019, 12, 602; doi: 10.3390 / en12040602

Statusi dhe Evolucioni i Sektorit të Energjisë së Komunitetit në Itali. *Energjitë* 2020, 13, 1888; doi: 10.3390 / en13081888

Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës në Komunitetin e Energjisë (2020). Plenumi Parlamentar i EnC

UN Women (2020) Raport për Barazinë Gjinore në Shqipëri 2020. Përgatitur nga Monika Kocaqi, AgustelaNini-Pavli, Ani Plaku dhe Dolly Wittberger.

WEFC, (2016). Studim i fizibilitetit të kooperativave energjetike të ndjeshme ndaj gjinisë në Gjeorgji, Ukrainë, Armeni dhe Moldavi

WEFC, ZEZ. Mars 2018. Kooperativat energjetike - Analizë krahasuese në vendet e Partneritetit Lindor dhe Ballkanin Perëndimor



# STUDIM LIDHUR ME KOMUNITETET E ENERGJISË PËR QYTETARËT NË SHQIPËRI

Supported by:



Federal Ministry  
for the Environment, Nature Conservation  
and Nuclear Safety



European  
Climate Initiative  
EUKI

based on a decision of the German Bundestag